Grupet e nxënësve përgatitin nga tri pyetje për grupet e tjera. Grupet e përzgjedhin udhëheqësin, i cili ka për detyrë ta prezentojë grupin.

#### **Vlerësimi:**

Nxënësit vlerësohen sipas bashkëpunimit në grup;

Në punë individuale;

Në kulturën debatuese.

## II. ZBULIMET E MËDHA GJEOGRAFIKE E NDRYSHUAN

### BOTËN 2. FILLET E ZBULIMEVE GJEOGRAFIKE

|  |                          |   |                    |
|--|--------------------------|---|--------------------|
| Fusha kurrikulare:<br><b>Shoqëria dhe Mjedis</b> | Lënda:<br><b>Histori</b> | Shkalla e kurrikulës:<br><b>Shkalla 4</b> | Klasa:<br><b>8</b> |
|--|--------------------------|---|--------------------|

**RNF:** 2.2. Shpjegon përbërjen e gjeosferës, si dhe analizon rolin e resurseve natyrore në mjedisin dhe në zhvillimin ekonomik të një vendi, rajoni, shteti apo kontinenti.

**RNSH:** Kompetenca I – 1, 5 , II- 7

#### • Rezultatet e të nxënët të lëndës:

**Nxënësi/ja:** numëron zbulimet kryesore gjeografike dhe dallon efektet e tyre në Evropë dhe më gjerë.

**Kriteri i suksesit:** kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë;

**Fjalë kyçë:** udhëtimet detare, Marko Pollo, mallrat tregtare, portugezët, mongolët, indianët, kinezët, rrugët e reja;

**Burimet:** libri, foto, harta gjeografike – atllas gjeografik;

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:** gjeografi.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

### Pjesa hyrëse:

Pjesa hyrëse e orës mësimore zhvillohet përmes teknikës *Stuhi mendimesh*. Mësimdhënësi/ja parashtron pyetje rreth njohurive paraprake që kanë nxënësit rreth temës që do të zhvillohet gjatë orës mësimore, si: keni dëgjuar për Marko Pollon? Për çfarë njihet ai? Çfarë zbuloi Marko Pollo?

Si quhet libri që e shkroi Marko Pollo për gjérat që e impresionuan gjatë aventurave të tij? Të gjitha mendimet e nxënësve shënohen në tabelë për të treguar se janë të vlerësuar, për të krijuar vetëbesim, për të krijuar respekt, si dhe për t'i motivuar dhe inkurajuar nxënësit për mësim, bashkëpunim dhe komunikim. Po ashtu, mësimdhënësi/ja përmes pyetjeve kërkohet ta bëjë edhe integrimin e lëndëve të tjera përmes çdo njësie mësimore.

### Pjesa kryesore:

Msimdhënsi/ja, njsin msimore e ndan n tri pjes. Pastaj i ndan nxnsit n grupe familjare, të cilët caktohen me numra nga 1 deri në 3. Të gjithë nxënësit e caktuar me numrin një bashkohen në një grup të përbashkët, dyshet në grup tjetër, treshet me treshe dhe kështu me radhë, të cilët në bazë të udhëzimeve, mësojnë në grup pjesën e caktuar nga mësimdhënësi/ja. Grupi me numrin një e lexon njësinë: *Udhëtimet e para dhe rëndësia e tyre*. Grupi me numrin dy lexon e njësinë mësimore: *Portugezët në kërkime të rrugëve të reja*. Grupi me numrin tre e lexon njësinë *Tregtarët mësimore: dhe kolonët portugezë u pasuruan shumë*.

Nxënësit në bashkëpunim e mësojnë njësinë dhe më pas reflektojnë te grupet e tyre familjare. Duke u nisur nga pjesa e parë, nxënësit do t'ua shpjegojnë nxënësve të tjerë pjesëzën e mësuar. Për ta kuptuar sa më mirë pjesën e njësisë mësimore, nxënësit parashtrojnë pyetje të ndryshme. Ky proces vazhdon deri kur të përfundohet e tërë njësia mësimore.

### **Pjesa përfundimtare:**

Në këtë fazë të orës mësimore, nxënësit shkruajnë një përbledhje të shkurtër për atë se çfarë kanë mësuar (ese reflektuese). Më pas, mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit e ndarë në grupe që të reflektojnë para tërë klasës për atë se çfarë kanë mësuar, por gjithnjë duke pasur kujdes që nxënësit ta marrin përgjegjësinë për mësimnxënienë të pavarur.

### **Aktivitete shtesë:**

Nxënësit e klasës ndahen në katër grupe. Secili grup ka për detyrë të emërojë udhëheqës/e të grupit. Udhëheqësit/et e grupit i udhëzojnë shokët e tyre që të përzgjedhin se çfarë aktiviteti dëshirojnë të marrin në lidhje me personalitetin e Marko Pollos.

Grupi i parë: të hulumtojë në media të shkruara dhe elektronike për aventurat e Marko Pollos.

Grupi i dytë: ta pikturojë figurën e Marko Pollos.

Grupi i tretë: të shikojnë një film për Marko Pollon.

Grupi i katërt: të shkruajë një ese për Marko Pollon.

Të gjitha aktivitetet e tyre prezantohen para gjithë klasës. Mësimdhënësi/ja cakton oraret për sa kohë duhet përgatitur (Detyrë shtëpie).

### **Vlerësimi:**

Vlerësimi i nxënësve për interesimin që shprehin në aktivitete të ndryshme.

Vlerësim në performancën e prezantimeve të projekteve.

Vlerësim në integrim të mediave.

### 3. ZBULIMI I AMERIKËS DHE ROLI I SPANJOLLËVE NË TOKAT E REJA

|   |                          |   |                    |
|---|--------------------------|---|--------------------|
| Fusha kurrikulare:<br><b>Shqëria dhe Mjedis</b> | Lënda:<br><b>Histori</b> | Shkalla e kurrikulës:<br><b>Shkalla 4</b> | Klasa:<br><b>8</b> |
|---|--------------------------|---|--------------------|

**RNF:** 2.2. Shpjegon përbërjen e gjeosferës, si dhe analizon rolin e resurseve natyrore në mjedisin dhe në zhvillimin ekonomik të një vendi, rajoni, shteti apo kontinenti.

**RNSH:** Kompetenca  
I – 1, II -1,6 III - 7

#### Rezultatet e të nxënësit të lëndës::

**Nxënësi/ja:** numëron zbulimet kryesore gjeografike dhe dallon efektet e tyre në Evropë dhe më gjërë.

Analizon rrethanat të cilat e mundësuan zbulimin e Amerikës.

Shpjegon fenomenin e skllavërisë dhe debaton për shtrirjen e këtij fenomeni.

**Kriteri i suksesit:** kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë;

**Fjalë kyçe:** Kristofor Kolombo, Amerika, ekspedita, spanjollët, Magelani, Kristofor Kolombo, Amerigo Vespuçi;

**Burimet:** libri, fotografitë, hartat gjeografike, atllasët gjeografikë;

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:** gjeografi.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

### Pjesa hyrëse:

Mësimdhënësi/ja në këtë fazë të orës mund ta përdorë teknikën Parashikim me terma paraprakë. Mësimdhënësi e ndan tabelën në dy kolona. Në secilën kolonë shkruan nga disa terma: Kolona 1- Kristofor Kolombo, Amerika, ekspedita;

Kolona 2 - Megalani, spanjollët, Ameriko Vespuçi.

Mësimdhënësi/ja, klasën e ndan në dy grupe të mëdha dhe grupet i udhëzon që nga termat e kolonave të tyre të krijojnë një histori të shkurtër. Pasi të përfundojnë, nxënësit i lexojnë vullnetarisht punimet e tyre të shkurtra.

### Pjesa kryesore:

Në vazhdim mësimdhënësi udhëzon nxënësit ta lexojnë tekstin në mënyrë individuale, duke vendosur shenjat:

shenja √ (tik), informacion i cili njihet nga nxënësit;

shenja – (minus), informacion i cili është i ndryshëm nga informacioni që ka pasur më parë;

shenja + (plus), informacion i ri;

shenja ? (pikëpyetje), informacion i paqartë për nxënësin.

Gjatë kohës që e lexojnë materialin, nxënësit vendosin shenja, më pas e plotësojnë tabelën sipas udhëzimeve të mësimdhënësit.

| ✓ | - | + | ? |
|---|---|---|---|
|   |   |   |   |

### Pjesa përfundimtare:

Në vijim lexohen disa prej punimeve të nxënësve, ndërsa mësimdhënësi e plotëson tabelën sipas reflektimit të nxënësve. Ndërkohe, mësimdhënësi/ja i shpjegon dhe i sqaron informacionet e paqarta që i kanë paraqitur nxënësit.

### Aktivitete shtesë:

Secili nxënës ka për detyrë që në mënyrë individuale t'i përgjigjet pyetjeve që janë të paraqitura në vijim, si dhe kërkohet nga e gjithë klasa që ta bëjnë përzgjedhjen e një moderatori, i cili do ta udhëheqë të gjithë diskutimin.

- 1) Shpjegoni arsyet e udhëtimeve të shpeshta detare të evropianëve.
- 2) Numëroni disa nga arritjet e Kristofor Kolombos.
- 3) Identifikoni arsyet e rivalitetit të spanjollëve dhe portugezëve.
- 4) Pse u bë i njohur Magelani?

### Vlerësimi:

Nxënësit vlerësohen për punë individuale.

Nxënësit vlerësohen për kulturë në komunikim.

Nxënësit vlerësohen për respektin që kanë për vetveten dhe ndaj njëri-tjetrit.

## **4. NDIKIMI SHOQËROR, POLITIK DHE EKONOMIK I ZBULIMEVE GJEOGRAFIKE**

|  |                          |   |                    |
|--|--------------------------|---|--------------------|
| Fusha kurrikulare:<br><b>Shoqëria dhe Mjedis</b> | Lënda:<br><b>Histori</b> | Shkalla e kurrikulës:<br><b>Shkalla 4</b> | Klasa:<br><b>8</b> |
|--|--------------------------|---|--------------------|

**RNF:** 2.1. Krahason ngjarjet shoqërore, historike, politike, ekonomike e kulturore, si dhe dukuritë (fenomenet) natyrore e mjedisore, shpjegon shkaqet dhe pasojat e tyre, si dhe ndikimin që kanë ato në jetën e njerëzve.

**RNSH:** Kompetenca I – 2, 7 II – 2

### **Rezultatet e të nxënëtit të lëndës:**

**Nxënësi/ja:** shpjegon ndryshimet në rrafshin ekonomik, kulturor dhe politik në “tokat e reja”, si rrjedhojë e kolonizimit evropian.

Identifikon krijimin e kolonive të para evropiane dhe vlerëson efektet e tyre për banorët indigenë.

**Kriteri i suksesit:** kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë;

**Fjalët kyçë:** anglezët, francezët, holandezët, “Bota e Re”, tregtarët, ekonomia, minierat, fiset indiane;

**Burimet:** libri, fotografitë, harta gjeografike, harta historike;

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:** gjeografi.

## **METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË**

### **Pjesa hyrëse:**

Në këtë fazë të orës, mësimdhënësi/ja i nxit nxënësit që të mendojnë lirshëm se çfarë dinë për temën *Ndikimi shoqëror, politik dhe ekonomik i zbulimeve gjeografike*. Më pastaj mësimdhënësi/ja fillon me parashtrimin e pyetjeve të ndryshme të cilat ndikojnë në zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve, siç janë:

- 1.) A mendoni se kanë ndikim të madh zbulimet e mëdha gjeografike në ekonomi?
- 2.) Cilat perandori u krijuan me zbulimet gjeografike dhe me kolonizimin e “Botës së Re”?
- 3.) Çfarë ju kujton viti 1492?

Ky aktivitet zhvillohet në mënyrë individuale, në formë të diskutimeve. Mësimdhënësi/ja idetë e nxënësve i shkruan në tabelë.

### **Pjesa kryesore:**

Në këtë fazë të orës, mësimdhënësi/ja i udhëzon nxënësit që ta lexojnë njësinë mësimore. Njësia mësimore është e ndarë në tre nëntituj: 1) *Anglezët, francezët dhe holandezët* në kërkim të tokave

të reja; 2) Ndjikimi ekonomik i zbulimeve gjografike dhe 3) Gërshetimi kulturor, asimilimi dhe pasojat e fiseve indiane të Amerikës.

Nxënësit në fillim e lexojnë pjesën e parë: Anglezët, francezët dhe holandezët në kërkim të tokave të reja dhe pastaj e mbyllin tekstin. Më pas, nxënësve u kërkohet që të formulojnë pyetje për t'i parashtruar njëri-tjetrit. Ata i parashtronjë pyetje njëri-tjetrit, duke i respektuar përgjigjet e njëri-tjetrit. Pas përfundimit të pjesës së parë, nxënësit vazhdojnë ta lexojnë pjesën e dytë të njësisë mësimore: Ndjikimi ekonomik i zbulimeve. Vazhdon e njëjtë procedurë, si më parë. Më pastaj vazhdohet me pjesën e tretë të njësisë: Gërshetimi kulturor, asimilimi dhe pasojat e fiseve indiane të Amerikës. Edhe për këtë njësi formulohen pyetje dhe vazhdon diskutimi me gjithë klasën. Në këtë proces edhe mësimdhënësja/i parashtron pyetje, mirëpo gjithmonë duke i nxitur nxënësit që ata të jenë në qendër të procesit mësimor, duke zhvilluar një mësimdhënie interaktive.

Pjesa përfundimtare:

Për reflektim, mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit/et që në dyshe t'i përsërisin çështjet kryesore të mësimit. Nxënësit/et në dyshe i shkruajnë pjesët më interesante të mësimit, më pastaj diskutojnë me njëri-tjetrin.

#### Aktivitete shtesë:

Mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit që në grupe të formuara nga 5 anëtarë, varësisht prej numrit të nxënësve që ka klasa, të punojnë nga një projekt me temat:

Grupi i parë: ta shpjegojë kuptimin e termave dhe koncepteve “Bota e Re”, konfliktet në mes kolonizatorëve, popullimi i tokës.

Grupi i dytë: ta identifikojnë rolin e anglezëve, francezëve dhe holandezëve në zbulimet gjografike.

Grupi i tretë: Çfarë ndikimi kishin zbulimet e mëdha gjografike në ekonomi?

Grupi i katërt: Analizoni pasojat e kolonizimit të Amerikës për fiset vendase.

(Detyrat realizohen në shtëpi, duke bashkëpunuar me njëri-tjetrin.)

#### Vlerësimi:

Nxënësit vlerësohen për angazhim individual dhe bashkëpunim në grup:

Për cilësinë e projekteve;

Për performanc; gjatë prezantimeve;

Për integrimin e mediave në hulumtime.

## 7. GJERMANIA DHE ITALIA

|  |                          |   |                    |
|--|--------------------------|---|--------------------|
| Fusha kurrikulare:<br><b>Shoqëria dhe Mjedis</b> | Lënda:<br><b>Histori</b> | Shkalla e kurrikulës:<br><b>Shkalla 4</b> | Klasa:<br><b>8</b> |
|--|--------------------------|---|--------------------|

**RNF:** 1.1 Analizon çështjet shoqërore, ekonomike, kulturore e arsimore që ndikojnë në individë dhe bashkësi, si dhe argumenton ndikimin e veprimeve të njeriut në mjedis.

**RNSH:** Kompetenca I - 1,2 III - 7

### Rezultatet e të nxënëtit të lëndës:

**Nxënësi/ja:** dallon personalitetet e rëndësishme botërore të periudhës moderne dhe vlerëson rolin dhe kontributin e tyre.

**Kriteri i suksesit:** kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë.

**Fjalë kyçe:** Perandori, zotërimi, Kyrfyrst, absolutizëm, Paqa e Utrehitit, reformë, regjent

**Burimet:** libri, interneti

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:** gjeografi

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

### Pjesa hyrëse:

Këtë fazë të orës mësimore, mësimdhënësi/ja e realizon duke e zhvilluar bisedën përmes pyetjeve me nxënës. Pyetjet që i parashtronen nxënësve mund të janë pyetje të hapura, të cilat e zhvillojnë mendimin kritik të nxënësve, duke ua mundësuar shprehjen e lirë të tyre. P.sh.: pse në Gjermani kishte shumë shtete? Çfarë njohurish keni për Gjermaninë, Francën dhe Italinë e sotme?

### Pjesa kryesore:

Në këtë pjesë të orës mësimore, mësimdhënësi/ja formon grupe nxënësish me po aq anëtarë sa pjesë (nëntituj) ka njësia mësimore. Meqenëse njësia mësimore përbëhet nga tri pjesë, atëherë edhe grupet duhet të janë treanëtarëshe. Njësia mësimore ndahet në tri pjesë, siç janë: 1) *Organizimi politik ne Gjermani*; 2) *Prusia, shteti më i fuqishëm gjerman* dhe 3) *Shtetet italiane në shek. XVIII*.

Mësimdhënësi/ja u jep udhëzime nxënësve se si të punohet: Ecuria: 1) Leximi bëhet me ndalesa pas secilës pjesë; 2) Të gjithë anëtarët e grupit lexojnë pjesën e parë; 3) Një anëtar i grupit luan rolin e mësuesit; 4) Anëtarë me rolin e mësuesit ka tri role: 1) shpjegon kuptimin e pjesës së lexuar; 2) jep përgjigje dhe sqarime në pyetjet e anëtarëve të grupit; 3) bën pyetje për anëtarët e tjerë të grupit. Ecuria është e njëjtë për të gjitha pjesët e mësimit, vetëm që nxënësit ndërrohen. Për secilën pjesë të mësimit bartet përgjegjësia e mësuesit te nxënësi tjetër.

## Pjesa përfundimtare

Për t'i nxitur nxënësit që të diskutojnë për përbajtjet mësimore që i mësuani gjatë realizimit të kuptimit, mësimdhënësi/ja në dërrasën e zezë formon një skemë, duke u bazuar në ulëset e nxënësve. Shtrohet një pyetje nga mësimdhënësi/ja, nxënësit ftohen që për dy minuta të shkruajnë përgjigje individuale. Pas dy minutave, nxënësit ftohen që t'i jasin idetë e tyre. Nëse ka përgjigje të kundërt nga dy nxënës, atëherë ftohet një nxënës i tretë ta japë mendimin e tij se me cilën përgjigje pajtohet dhe përsë pajtohet. Nga nxënësi kërkohet ta argumentojë përgjigjen. Mësimdhënësi/ja nuk jep vetë përgjigje dhe nuk përkrah një mendim kundrejt tjetrit. Me këtë ecuri vazhdohet edhe me pyetje të tjera.

### Aktivitete shtesë:

Nxënësit pasi ta kenë lexuar njësinë mësimore, secili grup e bën përzgjedhjen e një nxënësi, i cili ka përditësuar njësinë.

### Vlerësimi:

Nxënësit vlerësohen për angazhim individual dhe grupor;  
Nxënësit vlerësohen për gatishmëri dhe bashkëpunim në grup;  
Nxënësit vlerësohen në komunikim;  
Nxënësit vlerësohen për performancën e tyre gjatë intervistave.

## 8.SPANJA

|  |                          |   |                    |
|--|--------------------------|---|--------------------|
| Fusha kurrikulare:<br><b>Shoqëria dhe Mjedis</b> | Lënda:<br><b>Histori</b> | Shkalla e kurrikulës:<br><b>Shkalla 4</b> | Klasa:<br><b>8</b> |
|--|--------------------------|---|--------------------|

**RNF:**1.1. Analizon çështjet shoqërore, ekonomike, kulturore e arsimore që ndikojnë në individë dhe bashkësi, si dhe argumenton ndikimin e veprimeve të njeriut në mjedis.

**RNSH:** Kompetenca I – 6, II - 3

### Rezultatet e të nxënësit të lëndës:

**Nxënësi/ja:** dallon personalitetet e rëndësishme botërore të periudhës moderne dhe vlerëson rolin dhe kontributin e tyre.

**Kriteri i suksesit:** kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë;

**Fjalët kyçë:** Spanja, Karli V, Filipi II, kolonitë, pushteti, vendet e ulëta;

**Burimet:** libri, fotografitë, harta gjeografike, harta historike;

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:** gjeografi.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

### Pjesa hyrëse:

Në fazën fillestare mësimdhënësi/ja bën një stuhi mendimesh me pyetjet, si: ç'dini për Gadishullin e Pirinejeve? Po me fjalën absolutizëm çfarë kuptojmë? Përgjigjet që lidhen drejtpërdrejt me njësinë shënohen në tabelë dhe kërkohet që edhe nxënësit t'i shkruajnë në fletoret e tyre.

### Pjesa kryesore:

Nxënësit udhëzohen ta lexojnë tërë njësinë mësimore dhe t'i bëjnë pyetje njëri-tjetrit për dukuritë për të cilat janë më shumë të interesuar dhe që kanë nevojë për më shumë sqarime. Në rast se nxënësit nuk mund të jepin shpjegime, atëherë u ndihmon mësimdhënësi/ja, duke ua sqaruar çdo gjë që e kanë të paqartë. Pastaj, nxënësit bëjnë një organizues grafik, si:

| Mbretërit | Trashëgimtarët | Territoret e pushtuara |
|-----------|----------------|------------------------|
|           |                |                        |
|           |                |                        |
|           |                |                        |
|           |                |                        |

### Pjesa përfundimtare:

Në fazën përfundimtare, kërkohet që nxënësit, nga tabela grafike që e kanë plotësuar në realizim të orës mësimore, të diskutojnë në çifte dhe në grupe, duke i shkëmbyer idetë dhe mendimet e tyre. Në fund të orës mësimore, përfaqësuesit e grupeve reflektojnë për klasën dhe të gjitha idetë e tyre shënohen në tabelë.

### Aktivitete shtesë:

Nxënësit ndahen në katër grupe. Nga secili grup kërkohet që të përgjigjet në pyetjet:

Grupi 1. Shpjegoni procesin e fuqizimit të Mbretërisë Spanjolle;

Grupi 2. Portretizoni mbretin Filipit II;

Grupi 3. Identifikoni disa faktorë që ndikuan në dobësimin e shtetit spanjoll.

Këto aktivitete mund të zhvillohen në klasë, por edhe për detyrë shtëpie. Nxënësit inkurajohen të punojnë në grup.

### Vlerësimi:

Nxënësit/et vlerësohen për angazhim individual dhe angazhim në grup;

Nxënësit/et vlerësohen në performance gjatë prezantimeve të detyrate të shtëpisë;

Nxënësit/et vlerësohen në komunikim.

## 9. FRANCA - REVOLUCIONI BORGJEZ

|  |                          |   |                    |
|--|--------------------------|---|--------------------|
| Fusha kurrikulare:<br><b>Shoqëria dhe Mjedis</b> | Lënda:<br><b>Histori</b> | Shkalla e kurrikulës:<br><b>Shkalla 4</b> | Klasa:<br><b>8</b> |
|--|--------------------------|---|--------------------|

**RNF:** 3.1. Shfrytëzon në mënyrë kritike burime të ndryshme për t'i eksploruar dhe për t'i krahasuar ndryshimet dhe ngashshmëritë etnike, kulturore, sociale dhe religjioze në vende dhe periudha të ndryshme.

4.1. Arsyeton llojet e vendimmarrjes në jetën e përditshme shoqërore; kuption nevojën dhe rëndësinë e zbatimit të procedurave demokratike përgjatë proceseve.

**RNSH:** Kompetenca I – 6, II – 2,8, VI - 2

### Rezultatet e të nxënësit të lëndës:

**Nxënësi/ja:** identifikon dhe analizon deklaratat e të drejtave të njeriut (Bill of Rights, Deklaratën e Drejtave të Njeriut dhe Qytetarit, të Revolucionit Borgjez Francez).

Dallon sistemet e ndryshme shtetërore e qeverisëse të periudhës moderne dhe krahason mënyrat e vendimmarrjes institucionale (absolutizmi dhe parlamentarizmi).

Vlerëson evoluimin e të drejtave qytetare dhe ndryshimin e rolit të qytetarëve në vendimmarrje.

**Kriteri i suksesit:** kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë;

**Fjalë kyçe:** fisnikëria, kleri, fshatarët, të varfërit e qytetit;

**Burimet:** libri, interneti;

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:** ed. qytetare, sociologji.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

### Pjesa hyrëse:

Në këtë fazë të orës mësimore, mësimdhënësi/ja e përdor teknikën *Kllasteri apo Pema e mendimit*. Mësimdhënësi i nxit nxënësit që të mendojnë lirshëm se çfarë dinë për temën *Revolucioni borgjez*, kur janë hartuar deklaratat për të drejtat e njeriut, prej nga e ka zanafillën, etj. Nxënësit në mes të fletores e shkruajnë *Revolucioni borgjez*, duke krijuar një degëzim rreth asaj se ç'dinë për të. Ky aktivitet zhvillohet në dyshe. Mësimdhënësi/ja idetë e nxënësve i shkruan në tabelë dhe bën një degëzim sipas rendit logik.



### Pjesa kryesore:

Në vazhdim mësimdhënësi i udhëzon nxënësit që ta lexojnë tekstin në mënyrë individuale, duke vendosur shenjet: shenja ✓ (tik), informacion i cili njihet nga nxënësit; shenja – (minus), informacion i cili është i ndryshëm nga informacioni që ka pasur më parë; shenja + (plus), informacion i ri dhe shenja ? (pikëpyetje), informacion i paqartë për nxënësin. Gjatë kohës që e lexojnë materialin, nxënësit vendosin shenja, më pas e plotësojnë tabelën sipas udhëzimeve të mësimdhënësit.

| ✓ | - | + | ? |
|---|---|---|---|
|   |   |   |   |

### Pjesa përfundimtare:

Në vijim lexohen disa nga punimet e nxënësve, ndërsa mësimdhënësi e plotëson tabelën sipas reflektimit të nxënësve. Ndërkohë mësimdhënësi i shpjegon dhe i sqaron informacionet e paqarta që kanë paraqitur nxënësit.

### Aktivitete shtesë:

Nxënësit debatojnë për revolucionet borgjeze në Evropë. Përzgjidhet një nxënës/e që do ta udhëheqë debatin.

### Vlerësimi:

Nxënësit vlerësohen sipas bashkëpunimit në grup;

Në punë individuale;

Në kulturën debatuese.

## 10. DIKTATURA JAKOBINE

|   |                          |   |                    |
|---|--------------------------|---|--------------------|
| Fusha kurrikulare:<br><b>Shqëria dhe Mjedis</b> | Lënda:<br><b>Histori</b> | Shkalla e kurrikulës:<br><b>Shkalla 4</b> | Klasa:<br><b>8</b> |
|---|--------------------------|---|--------------------|

**RNF:4.1.** Arsyeton llojet e vendimmarjes në jetën e përditshme shoqërore; kuption nevojën dhe rëndësinë e zbatimit të procedurave demokratike përgjatë proceseve. **RNSH:** Kompetenca I – 6, II – 3, VI - 6

### Rezultatet e të nxënësit të lëndës:

**Nxënësi/ja:** vlerëson evoluimin e të drejtave qytetare dhe ndryshimin e rolit të qytetarëve në vendimmarje.

**Kriteri i suksesit:** kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë;

**Fjalë kyçe:** Franca, jakobinët, diktatura, Maksimilian Robespieri, mosmarrëveshjet, ekzekutimi;

**Burimet:** libri, interneti, fotografitë;

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:** ed.qytetare, sociologji.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

### Pjesa hyrëse:

Në këtë fazë të evokimit mund të përdoret teknika *Parashikim nëpërmjet fjalëve kyçe*. Kjo teknikë është e përshtatshme për lidhjen emocionale të nxënësit më njësinë e re mësimore. Ecuria është: caktohen katër-pesë fjalë që përdoren brenda mësimit dhe që i bëjnë kureshtarë nxënësit për përbajtjen e njësisë së re. Fjalët kyçe të mësimit: jakobinët, Komiteti i Shpëtimit Publik, Robespieri, mosmarrëveshje, ekzekutim. Me këto fjalë kyçe nxënësit thurin një ngjarje. Më pas nxënësit në dyshe shkëmbejnë ngjarjet e thurura apo lexohen disa nga këto krijime të nxënësve para gjithë klasës.

### Pjesa kryesore:

Mësimdhënësi/ja njësinë mësimore e ndan në katër pjesë. Por, fillimisht i ndan nxënësit në grupe familjare, të cilët do të caktohen me numra nga 1 deri në 4. Të gjithë nxënësit e caktuar me numrin një bashkohen në një grup të përbashkët, dyshet në grup tjetër, e kështu me radhë, të cilët në bazë të udhëzimeve e mësojnë në grup pjesën e caktuar nga mësimdhënësi. Të gjithë këta nxënës, të caktuar në grupet e tyre në bashkëpunim, e mësojnë njësinë sa më mirë, që më pas të reflektojnë te grupet e tyre familjare. Pjesën e parë të njësisë mësimore, nxënësit ua shpjegojnë grupeve të tjera. Ecuria vazhdon njëjtë edhe për grupet e tjera. Për ta kuptuar sa më mirë njësin mësimore.

nxënësit parashtronjë pyetje të ndryshme. Ky proces vazhdon derisa të përfundojë tërë njësia mësimore.

**Pjesa përfundimtare:**

Pas përfundimit të pjesës kryesore, nxënësit shkruajnë një përbledhje të shkurtër për atë se çfarë kanë mësuar (shkrim i lirë. Më pas, mësimdhënësi kërkon nga nxënësit e ndarë në grupe të reflektojnë para tërë klasës për atë se çfarë kanë mësuar, por gjithnjë duke pasur kujdes që nxënësit ta marrin përgjegjësinë për mësimnxëniet të pavarur.

**Aktivitete shtesë:**

Grupet e nxënësve përgatitin nga tri pyetje për grupet e tjera. Grupet e përzgjedhin udhëheqësin e grupit, i cili ka për detyrë ta prezentojë grupin.

**Vlerësimi:**

Nxënësit vlerësohen sipas bashkëpunimit në grup;

Në punë individuale;

Në performancën e tyre gjatë prezantimeve.

## 11. REVOLUCIONI BORGJEZ NË ANGLI

|  |                          |   |                    |
|--|--------------------------|---|--------------------|
| Fusha kurrikulare:<br><b>Shoqëria dhe Mjedis</b> | Lënda:<br><b>Histori</b> | Shkalla e kurrikulës:<br><b>Shkalla 4</b> | Klasa:<br><b>8</b> |
|--|--------------------------|---|--------------------|

|  |   |
|--|---|
| <b>RNF:</b> 4.1. Arsyeton llojet e vendimarrjes në jetën e përditshme shoqërore; kuption nevojën dhe rëndësinë e zbatimit të procedurave demokratike përgjatë proceseve.<br>4.2. Krahason llojet e ndryshme të vendimarrjeve dikur dhe tani, si dhe reagon dhe shpreh qëndrimet e tij/saj ndaj dukurive negative në bashkësinë ku vepron dhe në shoqëri. | <b>RNSH:</b> Kompetenca I – 2, II – 2,5 |
|--|---|

### Rezultatet e të nxënësit të lëndës:

**Nxënësi/ja:** dallon sistemet e ndryshme shtetërore dhe qeverisëse të periudhës moderne dhe krahason mënyrat e vendimarrjes institucionale (absolutizmi dhe parlamentarizmi). Vlerëson evoluimin e të drejtave qytetare dhe ndryshimin e rolit të qytetarëve në vendimarrje.

**Kriteri i suksesit:** kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë;

**Fjalë kyçë:** parlamenti, Anglia, froni mbretëror, Parlamenti i gjatë, republika, Kromvelli, diktatura;

**Burimet:** libri, mediat elektronike, fotografitë;

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:** ed. qytetare, sociologji.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

### Pjesa hyrëse:

Në këtë fazë të orës, mësimdhënësi i nxit nxënësit që të mendojnë lirshëm se çfarë dinë për temën *Ndikimi shoqëror, politik dhe ekonomik i zbulimeve gjeografike*. Më pastaj, mësimdhënësi/ja fillon me parashtrimin e pyetjeve të ndryshme, të cilat ndikojnë në zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve, siç janë:

1. Çka mendoni, si kishte ndikuar në jetën e anglezëve qeverisja gjatë sundimit të Stjuartëve?2.) Çfarë mendoni, pse u quajt “Parlamenti i gjatë” në Angli?

3.) Lufta Civile në Angli, në mes të cilave palë ndërluftuese u zhvillua?

Ky aktivitet zhvillohet në mënyrë individuale, në formë të diskutimeve. Mësimdhënësi/ja idetë e nxënësve i shkruan në tabelë.

### Pjesa kryesore:

Në këtë fazë të orës, mësimdhënësi/ja i udhëzon nxënësit që ta lexojnë njësinë mësimore.

Njësia mësimore është e ndarë në katër nëntituj:1) *Qeverisja pa parlament në kohën e Stuardëve; 2)*

*Pse u quajt “Parlamentit të gjatë”? 3) Lufta në mes të forcave të mbretit dhe parlamentit - Lufta civile dhe 4) Republika angleze nën udhëheqjen e Kromvellit.*

Nxënësit në fillim e lexojnë pjesën e parë: *Qeverisja pa parlament në kohën e Stjuartëve*, dhe pastaj e mbyllin tekstin. Më pas, nxënësve u kërkohet që të formulojnë pyetje për t’i parashtruar njëri-tjetrit. Ata i parashtronjë pyetje njëri-tjetrit, duke respektuar përgjigjet e njëri-tjetrit. Pas përfundimit të pjesës së parë, nxënësit vazhdojnë ta lexojnë pjesën e dytë të njësisë mësimore: *Pse u quajt “Parlamenti i gjatë”?* Vazhdon e njëjtë procedurë, si më parë. Më pastaj vazhdohet me pjesën e tretë të njësisë: *Lufta në mes të forcave të mbretit dhe parlamentit - Lufta Civile*. Pastaj vazhdohet me pjesën e katërt: *Republika angleze nën udhëheqjen e Kromvellit*. Edhe për këtë njësi formulohen pyetjet dhe vazhdon diskutimi me gjithë klasën. Në këtë proces parashtron pyetje edhe mësimdhënësja/i, mirëpo gjithmonë duke i nxitur nxënësit që të jenë në qendër të procesit mësimor, duke zhvilluar një mësimdhënie interaktive.

#### **Pjesa përfundimtare:**

Katër faza të ngjarjimit të përfundimit me një organizues grafik.

|                      | Në fillim | Gjatë | Në përfundim |
|----------------------|-----------|-------|--------------|
| Stjuartëve           |           |       |              |
| Parlamentit të gjatë |           |       |              |
| Luftës civile        |           |       |              |
| Kromvellit           |           |       |              |

#### **Aktivitete shtesë:**

Hulumtoni në internet për Anglinë gjatë periudhës së Republikës.

#### **Vlerësimi:**

Vlerësimi i vazhdueshëm;  
Vlerësim për aktivitete në grup;  
Vlerësim për pjesëmarrje në diskutim;  
Vlerësim individual në hulumtime.

## 12. REVOLUCIONI I LAVDISHËM I VITIT 1688

|  |                          |   |                    |
|--|--------------------------|---|--------------------|
| Fusha kurrikulare:<br><b>Shoqëria dhe Mjedis</b> | Lënda:<br><b>Histori</b> | Shkalla e kurrikulës:<br><b>Shkalla 4</b> | Klasa:<br><b>8</b> |
|--|--------------------------|---|--------------------|

**RNF:2.1.** Krahason ngjarjet shoqërore, historike, politike, ekonomike e kulturore, si dhe dukuritë (fenomenet) natyrore e mjedisore; shpjegon shkaqet dhe pasojat e tyre dhe ndikimin që kanë ato në jetën e njerëzve.

**RNSH:Kompetenca**  
I – 2, 6, II - 5, VI - 2

### Rezultatet e të nxënësit të lëndës:

**Nxënësi/ja:** shpjegon ndikimin e “Revolucionit të lavdishëm” dhe debaton për funksionimin e monarkisë parlamentare në Angli.

**Kriteri i suksesit:** kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë;

**Fjalët kyçë:** Kromvelli, parlamenti, fisnikëria, vigët, torët, Vilhelm Oranzhi;

**Burimet:** libri, interneti, fotografitë;

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:** ed. qytetare.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

Këtë njësi mësimore mund ta realizojmë përmes teknikës Ese argumentuese, që do të thotë përmes procesit të të shkruarit. Esenë argumentuese mund ta përdorim në të gjitha fazat e strukturës së orës mësimore, pasi nxit nxënësit për të shkruar mbi bazën e informacioneve. Mësimdhënësi/ja i inkurajon nxënësit të shkruajnë për temën sipas udhëzimeve të tij/saj sipas këtyre procedurave: Nxënësit mund të punojnë në mënyrë individuale apo në cifte.

Hapi i parë: kërkohet që temën mësimore ta shndërrojnë në formë të pyetjes.

Hapi i dytë: shkruhet një deklaratë, duke iu përgjigjur pyetjes së formuluar nga hapi i parë.

Hapi i tretë: nxënësit ia lexojnë njëri-tjetrit deklaratën e shkruar dhe bisedojnë rreth saj. Hapi i katërt: nxënësve u kërkohet t'i shkruajnë argumentet e tyre lidhur me qëndrimin e dhënë në fillim të esesë. Kjo organizohet përmes pyetjeve. P.sh.: pse mendoni kështu? Hapi i pestë: pasi t'i kenë shkruar argumentet, i lexojnë përsëri në çifte.

Hapi i gjashtë: kërkohet nga nxënësit që ta përfundojnë esenë me një paragraf, i cili shënon fundin e esesë argumentuese, por i bazuar në qëndrimet paraprake.

Hapi i shtatë: prapë lexohet në dyshe dhe në fund lexohet si tërësi e punimit.

Hapi i tetë dhe i fundit: kërkohet që nxënësit ta rishikojnë esenë e tyre dhe t'i bëjnë përmirësimet apo t'i plotësojnë mendimet (argumentet) e tyre.

Punimet e nxënësve mund të vendosen në mure ku mund të lexohen nga nxënësit e tjera të klasës.

**Aktivitete shtesë:**

Nxënësit diskutojnë për temën dhe kërkohet të bëjnë hulumtime në internet për “Deklaratën e të drejtave” në Angli.

**Vlerësimi:**

Vlerësim për kulturë të diskutimit;

Në punë individuale;

Vlerësim në hulumtime.

## 13. RUSIA

|   |                          |   |                    |
|---|--------------------------|---|--------------------|
| Fusha kurrikulare:<br><b>Shqëria dhe Mjedis</b> | Lënda:<br><b>Histori</b> | Shkalla e kurrikulës:<br><b>Shkalla 4</b> | Klasa:<br><b>8</b> |
|---|--------------------------|---|--------------------|

**RNF:4.2.** Krahason llojet e ndryshme të vendimmarrjeve dikur dhe tani, si dhe reagon dhe shpreh qëndrimet e tij ndaj dukurive negative në bashkësinë ku vepron dhe në shoqëri.

**RNSH:** Kompetenca  
I – 1, II – 1, III - 6

### Rezultatet e të nxënëtit të lëndës:

**Nxënësi/ja:** dallon sistemet e ndryshme shtetërore e qeverisëse të periudhës moderne dhe krahason mënyrat e vendimmarrjes institucionale (absolutizmi dhe parlamentarizmi). Dallon karakteristikat kryesore të absolutizmit në Evropë dhe krahason veçoritë e tij në vendet e ndryshme.

**Kriteri i suksesit:** kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë;

**Fjalë kyçe:** Rusia, romanovët, Mihail Romanovi, Petri i Madh, Katerina;

**Burimet:** libri, interneti, harta gjeografike;

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:** gjeografi, sociologji.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

### Pjesa hyrëse:

Në këtë fazë të orës, mësimdhënësi/ja i nxit nxënësit që të mendojnë lirshëm se çfarë dinë për shtetin e Rusisë. Më pastaj, mësimdhënësi/ja fillon me parashtrimin e pyetjeve të ndryshme të cilat ndikojnë në zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve, siç janë:

- 1) Çka mendoni, si ndikon në popullatë lufta e trashigimtarëve për fronin mbretëror?
- 2) Çfarë mendoni për sundimin e dinastisë Romanov në Rusi?
- 3) Pse është quajtur Petri i Madh?

Ky aktivitet zhvillohet në mënyrë individuale në formë të diskutimeve. Mësimdhënësi/ja idetë e nxënësve i shkruan në tabelë.

### Pjesa kryesore:

Në këtë fazë të orës, mësimdhënësi/ja i udhëzon nxënësit që ta lexojnë njësinë mësimore. Njësia mësimore është e ndarë në tre nëntituj:

- 1) *Rusia në kohën e Mihail Romanovit;*
- 2) *Petri i Madh sundon Rusinë;*
- 3) *Qeverisja e Rusisë nga Katarina II.*

Nxënësit, në fillim e lexojnë pjesën e parë: *Rusia në kohën e Mihail Romanovit*; pasi ta lexojnë e mbyllin tekstin. Më pas, nxënësve u kërkohet që të formulojnë pyetje për t’ia parashtuar njëri-tjetrit, duke i respektuar përgjigjet e tyre. Pas përfundimit të pjesës së parë, nxënësit vazhdojnë ta lexojnë pjesën e dytë të njësisë mësimore: *Petri i Madh sundon Rusinë*. Vazhdon e njëjtë procedurë si më parë. Më pastaj, vazhdohet me pjesën e tretë të njësisë: *Qeverisja e Rusisë nga Katarina II*. Edhe për këtë pjesë formulohen pyetjet dhe vazhdohet diskutimi me gjithë klasën. Në këtë proces parashtron pyetje edhe mësimdhënësja/i, mirëpo gjithmonë duke i nxitur nxënësit që ata të jenë në qendër të procesit mësimor, duke zhvilluar një mësimdhënie interaktive.

#### **Pjesa përfundimtare:**

Këtë fazë të orës mund ta përfundojmë me një organizues grafik.

Rusia gjatë sundimit të:

|                     | Ekonomia | Ushtria | Gjendja shoqërore |
|---------------------|----------|---------|-------------------|
| Ivanit të tmerrshëm |          |         |                   |
| Mihal Romanovit     |          |         |                   |
| Petrit të Madh      |          |         |                   |
| Katarinës II        |          |         |                   |

#### **Aktivitete shtesë:**

Hulumtoni në internet për Rusinë gjatë sundimit të Petrit të Madh.

#### **Vlerësimi:**

Vlerësimi i vazhdueshëm;

Vlerësim për pjesëmarrje në diskutim;

Vlerësim individual në hulumtime.

## 14. SHKENCA, KULTURA DHE ILUMINIZMI EVROPIAN

|   |                          |   |                    |
|---|--------------------------|---|--------------------|
| Fusha kurrikulare:<br><b>Shqëria dhe Mjedis</b> | Lënda:<br><b>Histori</b> | Shkalla e kurrikulës:<br><b>Shkalla 4</b> | Klasa:<br><b>8</b> |
|---|--------------------------|---|--------------------|

**RNF:**2.1. Krahason ngjarjet shoqërore, historike, politike, ekonomike e kulturore, si dhe dukuritë (fenomenet) natyrore e mjedisore, shpjegon shkaqet dhe pasojat e tyre e ndikimin që kanë ato në jetën e njerëzve.

2.2. Shpjegon përbërjen e gjeosferës, si dhe analizon rolin e resurseve natyrore në mjedisin dhe në zhvillimin ekonomik të një vendi, rajoni, shteti apo kontinenti.

**RNSH:**Kompetenca  
I – 2, 7, II - 5

### Rezultatet e të nxënëtit të lëndës::

**Nxënësi/ja:** identifikon rrethanat në të cilat u zhvillua iluminizmi (“Periudha e arsyesh”) dhe analizon ndikimet e tij në sferat kryesore të jetës.

Dallon rrymat kryesore në rrafshin kulturor dhe arsimor në periudhën moderne.

Identifikon të arriturat kryesore shkencore në periudhën moderne dhe ndikimet e tyre në shoqëri.

**Kriteri i suksesit:** kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë;

**Fjalë kyçë:** shkencë, letërsi, art, iluminizëm, ide përparimitare;

**Burimet:** libri, fotografitë, interneti;

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:** letërsi, art, gjeografi.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

### Pjesa hyrëse:

Mësimdhënësi/ja fillimisht diskuton me nxënësit për zhvillimet e shkencës kulturës dhe artin në botë. Mësimdhënësja/i, po ashtu, pyet nxënësit se sa kanë njojuri për dijetarët e njojur botërorë, cilët janë ata dhe çfarë veprimtarish kanë bërë. Disa prej përgjigjeve shënohen në tabelë.

### Pjesa kryesore:

Mësimdhënësi/ja paraprakisht njësinë mësimore e ndan në tri pjesë. Më pastaj, nxënësit ndahen në tri grupe familjare, të cilët caktohen me numra nga 1 deri në 3. Ndahen në tre grupe për arsy se njësia mësimore është e ndarë në tri pjesë.

Të gjithë nxënësit e caktuar me numrin një bashkohen në një grup të përbashkët, dyshet në grup tjetër, të cilët në bazë të udhëzimeve, e mësojnë në grup pjesën e caktuar nga mësimdhënësi/ja.

Të gjithë nxënësit në bashkëpunim me grupin e tyre mësojnë njësinë dhe më pas reflektojnë te grupet

e tyre familjare. Duke u nisur nga pjesa e parë, vetë nxënësit do t'ua shpjegojnë nxënësve të tjera pjesën e mësuar. Për ta kuptuar sa më mirë pjesën e njësisë mësimore, nxënësit parashtronjë pyetje të ndryshme. Ky proces vazhdon derisa të përfundohet e tërë njësia mësimore.

### **Pjesa përfundimtare:**

Pasi ta përfundojnë fazën e realizimit të njësisë mësimore, nxënësit udhëzohen të diskutojnë për pyetjen që ua parashtron mësimdhënësja/i: si ndikuan idetë iluministe në shoqërinë evropiane? Diskutimi zhvillohet me një respekt të ndërsjellë.

### **Aktivitete shtesë:**

Nxënësit e klasës bashkëbisedojnë me njëri-tjetrin për ndonjë film që kanë shikuar për ndonjë gjeni, i cili ka kontribuar në shkencë, art apo në ndonjë fushë tjeter. Po ashtu, nxënësit kanë mundësi të hulumtojnë në internet për figurat e këtyre dijetarëve dhe të krijojnë një album me fotografí që të njihen me figurat e tyre.

### **Vlerësimi:**

Vlerësimi i nxënësve për kulturën debutuese që tregojnë;

Vlerësimi i nxënësve për interesin që shprehin në aktivitete të ndryshme;

Vlerësim i nxënësve për hulumtime në media elektronike dhe media të shkruara;

Vlerësim formativ.

## V. AZIA - SHOQËRIA, EKONOMIA DHE POLITIKA E SHEK XVI-XVIII

### 15. INDIA, KINA DHE JAPONIA GJATË SHEKUJVE XVI-XVIII

|  |                          |   |                    |
|--|--------------------------|---|--------------------|
| Fusha kurrikulare:<br><b>Shoqëria dhe Mjedis</b> | Lënda:<br><b>Histori</b> | Shkalla e kurrikulës:<br><b>Shkalla 4</b> | Klasa:<br><b>8</b> |
|--|--------------------------|---|--------------------|

**RNF:** 2.1. Krahason ngjarjet shoqërore, historike, politike, ekonomike e kulturore, si dhe dukuritë (fenomenet) natyrore e mjedisore, shpjegon shkaqet dhe pasojat e tyre dhe ndikimin që kanë ato në jetën e njerëzve.

2.2. Shpjegon përbërjen e gjeosferës, si dhe analizon rolin e resurseve natyrore në mjedisin dhe në zhvillimin ekonomik të një vendi, rajoni, shteti apo kontinenti.

**RNSH:** Kompetenca  
I – 1, 6, II - 7

#### Rezultatet e të nxënëtit të lëndës:

**Nxënësi/ja:** shpjegon ndryshimet në rafshin ekonomik, kulturor dhe politik në “tokat e reja” si rrjedhojë e kolonizimit evropian.

Përshkruan organizimin shoqëror dhe politik të Kinës në kohën e dinstisë Ming dhe Qing dhe analizon raportet me vendet evropiane.

Përshkruan rrethanat e përgjithshme në Indi para vendosjes së sundimit britanik.

Analizon raportet mes Evropës dhe vendeve aziatike (Kina, Japonia, India) në rrafshin kulturor, shoqëror dhe ekonomik.

**Kriteri i suksesit:** kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë;


**Fjalë kyçe:** India, Kina, Japonia, dinasti, misionar jezuit, besimi i krishterë;

**Burimet:** libri, interneti, fotografitë, hartat historike, hartat gjeografike;

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/ apo çështjet ndërkurrikulare:** gjeografi.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

**Pjesa hyrëse:** Mësimdhënësi/ja i udhëzon nxënësit/et që t'i shprehin me anën e kllasterit ato që dinë për Indinë, Kinën dhe Japoninë.



**Pjesa kryesore:** Nxënësit ndahan në tri grupe dhe numërohen nga 1-3. Nxënësit njoftohen se njësia mësimore është e ndarë në tri pjesë (nëntituj): 1) India; 2) Kina dhe 3) Japonia. Nxënësit që kanë numrin 1 janë përgjegjës që të mësojnë për pjesën e parë të njësisë ku flitet për Indinë. Nxënësit që e kanë numrin 2 mësojnë për Kinën, ndërsa nxënësit që e kanë numrin 3 mësojnë për Japoninë. Pas leximit të pjesëve të njësisë, nxënësit që e kanë numrin 1 ulen së bashku, nxënësit me numër 2, po ashtu, ulen bashkë dhe kështu edhe nxënësit me numrin 3. Nxënësit njoftohen se grupet e formuara tani quhen grupe ekspertësh, ndërsa grupet fillojnë quheshin grupe familjare apo të bashkëpunimit. Grupet e ekspertëve njoftohen se pas mësimit të pjesës (10-15 min.) duhet të kthehen në grupe familjare dhe atje t'ua shpjegojnë anëtarëve të tjerë të grupit pjesën që e kanë mësuar. Po ashtu, edhe grupet e ekspertëve fillojnë ta mësojnë bashkërisht pjesën e tyre dhe të shkëmbijnë pyetje në mes vete. Të dy grupet si përfundim mund t'i shënojnë të gjitha paqartësitë që kanë dhe pastaj të diskutojnë së bashku. Kështu kompletohet shpjegimi i gjithë përbajtjes. Qëllimi përfundimtar është që secili nxënës t'i mësojë tri pjesët e njësisë. Pas shtjellimit të njësisë mësimdhënësi/ja paraqet një hartë të botës dhe i udhëzon nxënësit që për disa minuta ta lidhin informacionin e marrë me vendet që mësuan. Apo më pas nxënësit mund të hartojnë një hartë të thjeshtë dhe t'i vendosin emërtimet e vendeve që ata i lexuan në pjesën e leximit.

**Pjesa përfundimtare** Në këtë fazë të orës mësimdhënësi/ja secilit grup ia jep një fletë me emrin e temave që i kanë mësuar në realizim të kuptimit. Secili grup shkruan ndonjë mendim të tyre për temën. Fletat përcillen prej një grupei te tjetri, derisa të gjitha grupet t'i shkruajnë mendimet e tyre për temën apo t'i plotësojnë mendimet që i kanë dhënë grupet e tjera. Ndonjëri prej nxënësve i lexon të gjitha mendimet e tyre për temën.

#### Aktivitete shtesë:

Nxënësve u kërkohet të diskutojnë për dallimet dhe ngjajshmëritë në mes Kinës, Japonisë dhe Indisë. Po ashtu, mësimdhënësi/ja ua parashton nxënësve pyetjen: si ju duk realizimi i kësaj ore mësimore? Nxënësit e diskutojnë dhe vlerësojnë realizimin e orës mësimore.

#### Vlerësimi:

Nxënësit/et vlerësohen për angazhimin dhe bashkëpunimin në grup;

Nxënësit/et vlerësohen për pjesëmarrjen aktive në diskutim;

Nxënësit/et vlerësohen për cilësinë e punës që prezantojnë.

**VI. SHQIPTARËT NË PERIUDHËN PAS-SKËNDERBEGIANE DERI NË SHEK.  
XVIII 16. KTHIMI I GJON KASTRIOTIT NË SHQIPËRI DHE PËRPJEKJET  
PËR RIMËKËMBJEN E SHTETIT SHQIPTAR**

|  |                          |   |                    |
|--|--------------------------|---|--------------------|
| Fusha kurrikulare:<br><b>Shoqëria dhe Mjedis</b> | Lënda:<br><b>Histori</b> | Shkalla e kurrikulës:<br><b>Shkalla 4</b> | Klasa:<br><b>8</b> |
|--|--------------------------|---|--------------------|

**RNF:1.1** Dallon faktet nga opinionet, figurat reale nga ato mitike e legjendare, gjatë interpretimit të situatave të ndryshme në marrëdhëniet midis individëve apo të grupeve shoqërore (në kohë dhe hapësirë).

**RNSH:** Kompetenca  
I – 2, 3, IV - 1

**Rezultatet e të nxënëtit të lëndës:**

**Nxënësi/ja:** analizon rolin e personaliteteve të rëndësishme shqiptare të periudhës moderne dhe vlerëson rolin dhe kontributin e tyre.

**Kriteri i suksesit:** kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë;  
**Fjalë kyçe:** pushtimet në Itali, Mbretëria e Napolit, Venediku, Gjon Kastrioti, Gjergj Kastrioti;  
**Burimet:** libri, fotografitë, harta gjeografike, harta historike;  
**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:** gjeografi, arkeologji.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

**Pjesa hyrëse:**

Mendo dhe puno në dyshe. Në këtë fazë të orës mësimore mësimdhënësi/ja kërkon nga anëtarët e grupit që të bashkohen në dyshe dhe më pas të veprohet sipas këtyre hapave: njëri nga anëtarët në çift ka për detyrë të shkruaj një temë. P.sh.: përshkruani një film apo sekuneca filmike, që ka të bëjë me qëllimin e rikthimit të pushtetit në duart e trashëgimtarëve legitimë. Ndërsa anëtarë tjetër i çiftit shkruan një rast të ndonjë filmi, kur ka pasur tentativa për ruajtjen e pushtetit, pavarësisht nga e drejta legitime e trashëgimisë apo jo. Pasi ta kenë përfunduar të shkruarit, dyshet i shkëmbejnë përvojat. Në fund brenda secilit grup, një apo dy dyshe i trejgnë përvojat për të cilat kanë shkruar dhe diskutimi vazhdon me pyetje të tjera që rrjedhin nga situala në klasë.

**Pjesa kryesore:**

Formohen grupe nxënësish me po aq anëtarë sa ka edhe pjesë të mësimit. Mësimdhënësi/ja jep udhëzime se si të punohet (mësimdhënia e ndërsjellë). Leximi bëhet me ndalesa pas secilës pjesë.

Të gjithë anëtarët e grupit fillojnë ta lexojnë pjesën e parë. Një anëtar i grupit e luan rolin e mësuesit. Puna e tij ka tri role:

- 1) shpjegon kuptimin e pjesës së lexuar;
- 2) jep përgjigje, sqarime në pyetjet e anëtarëve të grupit;
- 3) bën një pyetje për anëtarët e tjerë të grupit për leximin vijues, duke e luajtur rolin e mësuesit. Ecuria vazhdon me leximin e dytë nga të gjithë anëtarët e grupit. Vazhdohet si në pjesën e parë. Puna mund të zhvillohet edhe në grupe, varësisht nga numri i nxënësve në klasë.

#### Pjesa përfundimtare:

Mësimdhënësi/ja shkruan në tabelë (dërrasë të zezë emrin e temës apo një emër që ka të bëjë me këtë temë. Meqenëse në këtë njësi kemi të bëjmë me “Kthimin e Gjon Kastriotit në Shqipëri”, atëherë marrim fjalën Gjon Kastrioti dhe e shkruajmë në tabelë, po ashtu edhe nxënësit, më pastaj vazhdojmë tutje. Nën emër shënojmë dy mbiemra, që nxënësit së pari në mënyrë individuale i shkruajnë, pastaj vazhdojmë me tri folje, një fjali përfundimtare dhe me sinonimin e fjalës.

- |               |                |       |       |
|---------------|----------------|-------|-------|
| 1.            | GJON KASTRIOTI |       |       |
| 2. dy mbiemra | _____          | _____ | _____ |
| 3. tri folje  | _____          | _____ | _____ |
| 4. një fjali  | _____          | _____ | _____ |
| 5. sinonimi   | _____          | _____ | _____ |

#### Aktivitete shtesë:

Nxënësit bëjnë dialog për temën *Të drejtat e popujve për krijimin e shteteve nacionale*. Nxënësit, përzgjedhin një moderatorë/e i/e cili/a do ta udhëheqë debatin. Nxënësit mund të nxjerrin edhe përfundime gjatë diskutimeve.

#### Vlerësimi:

Nxënësit vlerësohen për punë individuale;  
Nxënësit vlerësohen për angazhim në grup dhe respekt të ndërsjellë;  
Nxënësit vlerësohen për angazhimin e tyre në debat.

## 18. ORGANIZIMI I KUVENDEVE SHQIPTARE DHE BALLKANIKE

|   |                          |   |                    |
|---|--------------------------|---|--------------------|
| Fusha kurrikulare:<br><b>Shqeria dhe Mjedis</b> | Lënda:<br><b>Histori</b> | Shkalla e kurrikulës:<br><b>Shkalla 4</b> | Klasa:<br><b>8</b> |
|---|--------------------------|---|--------------------|

**RNF:**1.3 Debaton për veprimet dhe çështjet e rëndësishme të qytetarëve në nivel lokal, kombëtar e më gjerë dhe ndërvarësinë e tyre.

**RNSH:**Kompetenca  
I – 2, 5. II – 5. III – 7.

### Rezultatet e të nxënëtit të lëndës:

**Nxënësi/ja:** analizon shkaqet e kryengritjeve arbërore/shqiptare kundër pushtetit osman dhe vlerëson bashkëpunimin e popujve të Ballkanit për çlirim.

**Kriteri i suksesit:** kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë;

**Fjalë kyçë:** kuvendet shqiptare, kuvendet ballkanike, ndihmat, kryengritja;

**Burimet:** libri, interneti, harta gjeografike, harta historike;

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:** gjeografi.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

### Pjesa hyrëse:

Mësimdhënësi/ja u parashtron nxënësve pyetje se a kanë dëgjuar ndonjëherë për kuvendet ballkanike. Çfarë kuptoni me kuvend? Si do të dukeshin kuvendet shumëkombëshe? Në çfarë raste do të mblidheshin kombet e ndryshme në kuvende të përbashkëta rajonale? Po Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB)? Nxënësit bashkëbisedojnë me njëri-tjetrin për mundësinë dhe shkaqet e një kuvendi të përbashkët, i cili do të mund të funksiononte në Ballkan, sidomos kur dihet për kundërshtitë e popujve që jetojnë në të.

### Pjesa kryesore:

Në këtë fazë të orës përdoret teknika *fleta e ekspertit*, përmes së cilës mësimdhënësi/ja paraprakisht e ka njësinë mësimore të ndarë në tri pjesë, të cilat do t'ua caktojë nxënësve t'i mësojnë. Por, fillimi i ndan nxënësit në grupe familjare, të cilët do të caktohen me numra nga 1 deri në 3. Të gjithë nxënësit e caktuar me numrin një bashkohen në një grup të përbashkët, dyshet në grup tjeter dhe kështu me radhë, të cilët në bazë të udhëzimeve e mësojnë në grup tërë njësinë mësimore, për t'i gjetur përgjigjet e pyetjeve të parashtruara nga mësimdhënësi/ja. Pyetjet duhet të janë të përfshira nga e tërë njësia mësimore, në mënyrë që nxënësit ta lexojnë jo vetëm

një pjesë, por komplet njësinë. P.sh.: për grupin e parë pyetjet mund të jenë:

1. Si ishte organizimi i rezistencës shqiptare ndaj pushtuesit osman në raport me kohën e Skënderbeut?
2. Tregoni cilat krahina shqiptare kishin organizuar kryengritje popullore kundër pushtuesve osman?
3. Cilat ishin vendimet që ishin marrë në kuvendet shqiptare?
4. Pse quhen kuvende ballkanike? Ky proces vazhdon deri sa të përfundohet e tërë njësia mësimore.

Pyetjet formulohen të ndryshme për të gjitha grupet, në mënyrë që, kur të bashkohen në grupe familjare, të kompletohet njësia mësimore.

Të gjithë nxënësit duhet të mësojnë t'u përgjigjen sa më mirë të gjitha pyetjeve të hartuara nga mësimdhënësi/ja në grupet e tyre të ekspertëve, që më pas të reflektojnë te grupet e tyre familjare.

Te nxënësit, kjo teknikë pune krijon përgjegjësi personale dhe kolektive.

#### **Pjesa përfundimtare:**

Në këtë fazë të orës mësimore, mësimdhënësi/ja në dërrasë të zezë shkruan një pyetje me mundësi të përgjigjes me *po* dhe *jo*. Të njëjtën gjë e bëjnë nxënësit në fletoret e tyre. P. sh.: "A duhet të angazhohen më shumë politikat shtetërore, për të krijuar miqësi dhe interesa të përbashkëta për një të ardhme më të mirë për popujt e Ballkanit?" Në anën e majtë shënojnë **po**, ndërsa në anën e djathtë të fletës shënojnë **jo**. Pastaj argumentojnë pse po mendojnë se angazhimi i tyre është i mjaftueshëm dhe pse nuk është angazhimi i mjaftueshëm. Puna bëhet në çifte. Pastaj çiftet bashkëpunojnë me njëri-tjetrin në grupet punuese, diskutojnë, krahasojnë dhe shtojnë arsyet e tyre. Pastaj tjerët nxënësit lëvizin nëpër grupe, duke i formuar tri grupe. Grupin që është për *po*, grupin që është për *jo* dhe grupin që është i pavendosur. Pastaj, grupet që janë për *po* dhe grupet që janë për *jo*, diskutojnë për t'i përgatitur argumentet e tyre, për ta forcuar pozicionin që e mbajnë. Hapet diskutimi ndërmjet anëtarëve të grupit, bëhet një debat me tërë klasën dhe nxënësit që i ndërrojnë bindjet e tyre mund të kalojnë nga një grup në një grup tjeter.

#### **Aktivitete shtesë:**

Nxënësit diskutojnë për kuvendet shqiptare dhe i identifikojnë arsyet e dështimit të kuvendeve ballkanike. Gjatë diskutimit, nxësnësit/et paraqesin një respekt të ndërsjellë.

#### **Vlerësimi:**

Nxënësit vlerësohen në mënyrë individuale;

Nxënësit vlerësohen në aftësitë argumentuese;

Për cilësinë e debatit dhe të prezantimeve;

Nxënësit vlerësohen për interesimin e tyre në pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme.

## 19. RELIGJONI NDËR SHQIPTARË

|  |                          |   |                    |
|--|--------------------------|---|--------------------|
| Fusha kurrikulare:<br><b>Shoqëria dhe Mjedis</b> | Lënda:<br><b>Histori</b> | Shkalla e kurrikulës:<br><b>Shkalla 4</b> | Klasa:<br><b>8</b> |
|--|--------------------------|---|--------------------|

**RNF:** 1.1 Analizon çështjet shoqërore, ekonomike, kulturore e arsimore që ndikojnë në individë dhe bashkësi, si dhe argumenton ndikimin e veprimeve të njeriut në mjedis.

**RNSH:** Kompetenca  
I – 6. II – 2,5. III - 5

### Rezultatet e të nxënëtit të lëndës:

**Nxënësi/ja:** shpjegon ngritjen e sistemit administrativ osman në trevat arbërore dhe identifikon faktorët që ndikuan në ndryshimin e strukturës fetare të arbërve/shqiptarëve.

**Kriteri i suksesit:** kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë;

**Fjalë kyçe:** kisha, ortodoks, katolik, konvertim, islam, bektashi;

**Burimet:** libri, fotografitë, harta gjeografike, harta historike;

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:** letërsi, arkeologji, art.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

### Pjesa hyrëse:

Mësimdhënësi/ja e fillon bashkëbisedimin me nxënës në formë të pyetjeve dhe përgjigjeve me nxënës. Nxënësit udhëzohen të shkruajnë në mënyrë individuale për religionin si fenomen botëror. Mund të shkruajnë për llojet e ndryshme të religjioneve në botë. Nxënësit shkruajnë lirshëm, pa kufizime dhe më pastaj bashkëbisedojnë në çifte e grup dhe më vonë prezentojnë në emër të grupit para klasës.

### Pjesa kryesore:

Gjatë kësaj faze të orës nxënësit udhëzohen të lexojnë në mënyrë individuale. Më pastaj, kanë për detyrë të përzgjedhin një pjesë të njësisë mësimore, të marrin shënimë, të formulojnë pyetje për shokun, të komentojnë në dyshe e më pastaj në grup. Pasi të përfundojnë, mund të ketë edhe diskutime (mendo, puno në çifte, thuaja grupit).

### Pjesa përfundimtare:

Pasi të kenë përfunduar, mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit që të paraqesin përmes vizatimit, shkrimit, për atë se çfarë kanë mësuar për religionin. Pasi të kenë vizatuar, fletët e tyre mund të

bëhen në formë të posterit dhe të vihen në mure të klasës. Nxënësit e tjerë kanë për detyrë ta shikojnë dhe ta lexojnë reflektimin e postuar dhe pastaj edhe të shënojnë ndonjë koment apo të shtojnë ndonjë gjë.

### **Aktivitete shtesë:**

Nxënësit në mënyrë individuale udhëzohen që të përzgjedhin ndonjë nga religjonet dhe të bëjnë një prezantim me PowerPoint para klasës. Mund ta marrin si temë edhe lindjen e religjionit dhe zhvillimin e tij nëpër periudha të ndryshme historike.

### **Vlerësimi:**

- Nxënësit vlerësohen për punën individuale;
- Nxënësit vlerësohen për angazhimin e tyre në art;
- Nxënësit vlerësohen për cilësinë e prezantimit;
- Nxënësit vlerësohen për angazhimin në hulumtime.

## 20. QYTETET SHQIPTARE GJATË SHEKUJVE XVI-XVIII

|   |                          |   |                    |
|---|--------------------------|---|--------------------|
| Fusha kurrikulare:<br><b>Shqeria dhe Mjedis</b> | Lënda:<br><b>Histori</b> | Shkalla e kurrikulës:<br><b>Shkalla 4</b> | Klasa:<br><b>8</b> |
|---|--------------------------|---|--------------------|

**RNF:**1.3. Debaton për veprimet dhe çështjet e rëndësishme të qytetarëve në nivel lokal, kombëtar e më gjerë dhe ndërvarësinë e tyre.

**RNSH:**Kompetenca  
I – 5. II – 1. III - 6

### Rezultatet e të nxënësit të lëndës:

**Nxënësi/ja:** përshkruan zhvillimin socio-ekonomik dhe urbanistik të qyteteve arbërore/ shqiptare në shekujt XVI-XIX.

**Kriteri i suksesit:** kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë;

**Fjalë kyçe:** qytete, tregje, zejtaria, qytetet më të mëdha, esnafet, gildet;

**Burimet:** libri, foto, harta gjeografike;

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:** arkeologji, art.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

### Pjesa hyrëse:

Në këtë fazë të orës mësimore, mësimdhënësi/ja përmes teknikës *Stuhi mendimesh* fillon me disa pyetje që i nxisin dhe i motivojnë nxënësit/et për mësim. Mësimdhënësi/ja fillon me pyetjet: cilat qytete të Kosovës njihen për ngjarje historike? Po në Shqipëri? A dini ndonjë qytet shqiptar, që sot gjendet në ndonjë shtet tjeter? Çfarë mendoni, cilat qytete kanë luajtur rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik e kulturor në kohëra më të vjetra? Të gjitha mendimet e ndryshme të nxënësve, mësimdhënësja/i i shkruan në tabelë, gjë që i kompletion idetë e nxënësve rreth njësisë apo temës për të cilën diskutohet.

### Pjesa kryesore:

Në këtë fazë të orës mësimore, mësimdhënësja/i i ndan nxënësit në grupe. Pastaj, mësimdhënësi/ja i udhëzon nxënësit që njësinë mësimore ta lexojnë pjesë-pjesë, të ndarë në paragrafë, ku pas çdo paragrafi do të ketë ndalesa. Nxënësit gjatë zbatimit të kësaj teknike do t'i luajnë dy role: rolin e mësuesit, që nxënësi i cili luan këtë rol, pas çdo ndalese do t'u shpjegojë njësinë mësimore anëtarëve të tjerë të grupit, do të përgjigjet në pyetjet të cilat i parashtrojnë anëtarët e grupit dhe përfund do t'u parashtrojë pyetje anëtarëve të grupit, për ta vërtetuar se a e kanë kuptuar atë që ai ka shpjeguar. Nëse grupet janë të formuara nga numër çift, atëherë secilit i bie të shpjegojë barabartë. Në këtë teknikë luhet roli i mësuesit dhe dëgjuesit.

**Pjesa përfundimtare:**

Në këtë fazë nxënësit mund të reflektojnë përmes një shkrimi të lirë për jetën, zhvillimin ekonomik dhe shoqëror në qytetet shqiptare gjatë shekujve XVI – XVIII.

**Aktivitete shtesë:**

Secili grup ka për detyrë të pikturojë nga një pamje të një qyteti që i ka lënë përshtypje gjatë vizitave të ndryshme.

**Vlerësimi:**

Nxënësit/et vlerësohen për bashkëpunim në grup;  
Nxënësit/et vlerësohen për iniciativë dhe vendimmarrje;  
Nxënësit vlerësohen për punë individuale.

## 21. ARSIMI, KULTURA DHE ARTI TE SHQIPTARËT GJATË SHEKUJVE XVI-XVII

|   |                          |   |                    |
|---|--------------------------|---|--------------------|
| Fusha kurrikulare:<br><b>Shqëria dhe Mjedis</b> | Lënda:<br><b>Histori</b> | Shkalla e kurrikulës:<br><b>Shkalla 4</b> | Klasa:<br><b>8</b> |
|---|--------------------------|---|--------------------|

**RNF:**1.1 Analizon çështjet shoqërore, ekonomike, kulturore e arsimore që ndikojnë në individë dhe bashkësi, si dhe argumenton ndikimin e veprimeve të njeriut në mjedis.

**RNSH:**Kompetenca  
I – 5. II – 1. III - 6

### Rezultatet e të nxënët të lëndës:

**Nxënësi/ja:** pëershruan zhvillimin socio-ekonomik dhe urbanistik të qyteteve arbërore/ shqiptare në shekujt XVI-XIX.

**Kriteri i suksesit:** kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë;

**Fjalët kyçe:** gjuha, shkollat, arsimi, letërsia, Gjon Buzuku, Pjetër Budi, Bogdani, Lekë Matrenga, gojëdhënët, eposi;

**Burimet:** libri, burimet nga interneti, fotografitë;

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:** letërsi.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

### Pjesa hyrëse:

Mësimdhënësi/ja e fillon bashkëbisedimin me nxënës në formë të pyetjeve dhe përgjigjeve. Nxënësit udhëzohen të shkruajnë në mënyrë individuale për ndonjë autor të librit me origjinë shqiptare, pavarësisht përbajtjes fetare, historike, kronikë apo letrare. Nxënësit shkruajnë të lirë, pa kufizime, i arsyetojnë shkrimet e tyre dhe pastaj bashkëbisedojnë në çifte e e grup e më vonë prezentojnë para klasës.

### Pjesa kryesore:

Nxënësit udhëzohen që gjatë leximit të tekstit, të përzgjedhin një apo më shumë pjesë të tekstit, që për ata janë më interesante. Pasi të përzgjedhin, nxënësit e shkruajnë në një fletë, pjesën e përzgjedhur dhe numrin e faqes, përfundimisht treguar se ku e kanë marrë. Në anën e kundërt të fletës shkruhet një koment për citatin (pse e kanë përzgjedhur atë pjesëz, cila është rëndësia e kësaj pjesë, çfarë njojuri të reja kanë marrë etj.). Njëri nga nxënësit e grüpuit e tregon faqen ku e kanë marrë pjesën, e lexon atë, ndërsa të tjerët e përvjelin në libër gjatë leximit. Pasi ta lexojë, të tjerët diskutojnë rreth citatit. Në fund të diskutimit, nxënësi i cili është përcaktuar për pjesën, i lexon komentin e tij për atë citat. Pas leximit të këtij komenti, nxënësit e tjerë nuk kanë të drejtë të japid komente shtesë. E njëjtë ecuri e leximit të citatit dhe komentit praktikohet edhe te nxënësit e tjerë.

### Pjesa përfundimtare:

Në këtë fazë të orës mësimore mësimdhënësi/ja i jep secilit nxënës nga një fletë, në të cilën si detyrë ua parashtron që të shkruajnë përfundimtare, një detyrë, një pyetje apo një problem. Nxënësit

në grup i shkruajnë mendimet e tyre për temën apo pyetjen që u parashtrohet nga mësuesi/ja. Pastaj, kur grupet ta përfundojnë punën në fletën e vet, fletat përcillen nga një grup te tjjetri, derisa të gjitha grupet t'i shkruajnë mendimet e tyre për temën apo t'i plotësojnë mendimet që i kanë dhënë grupet tjera.

### Aktivitete shtesë:

Nxënësit në mënyrë individuale udhëzohen t'i hulumtojnë në internet autorët shqiptarë të periudhës së mesjetës.

### Vlerësimi:

Nxënësit vlerësohen për punën individuale;  
Nxënësit vlerësohen për angazhimin e tyre në grup;  
Nxënësit vlerësohen për cilësinë e prezantimit;  
Nxënësit vlerësohen për hulumtime në internet.

## VII. PERANDORIA OSMANE DHE BALLKANI GJATË SHEKUJVE XVI-XVIII

### 22. SHTETI OSMAN NË SHEKUJT XVI-XVIII

|                             |                |                       |          |
|-----------------------------|----------------|-----------------------|----------|
| Fusha kurrikulare:          | Lënda:         | Shkalla e kurrikulës: | Klasa:   |
| <b>Shoqëria dhe Mjedisë</b> | <b>Histori</b> | <b>Shkalla 4</b>      | <b>8</b> |

**RNF:**2.1. Krahason ngjarjet shoqërore, historike, politike, ekonomike e kulturore, si dhe dukuritë (fenomenet) natyrore e mjedisore, shpjegon shkaqet dhe pasojat e tyre, si dhe ndikimin që kanë ato në jetën e njerëzve.

**RNSH:**Kompetenca  
I – 1, 6. II - 7

#### Rezultatet e të nxënëtit të lëndës::

**Nxënësi/ja:** dallon tiparet kryesore të organizimit administrativ-shtetëror dhe shoqërор тë Perandorisë Osmane dhe Habsburge dhe i krahason ato.

**Kriteri i suksesit:** kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë;

**Fjalë kyçë:** osman, ushtria, pushtimet, Evropa, Azia, Afrika, dobësimi;

**Burimet:** libri, burime nga interneti, harta gjeografike, harta historike;

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:** gjeografi.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

### Pjesa hyrëse:

Në këtë fazë të orës nxënësit udhëzohen të shkruajnë një shkrim të lirë për të arriturat e Perandorisë Osmane në fushën e zgjerimit territorial në kontinentet përreth. Pastaj, disa nga punimet e nxënësve do të lexohen në klasë.

### Pjesa kryesore:

Në këtë fazë të orës mësimore mësimdhënësi/ja përdor teknikën *DRTA*. Mësimdhënësi/ ja i udhëzon nxënësit për të lexuar me vëmendje, për arsy se do të përgjigjen në pyetjet që do të parashtrohen pas çdo ndalese të njësisë mësimore. Meqenëse njësia mësimore përbëhet nga dy nëntituj, atëherë mësimdhënësi/ja njësinë e ndan në disa ndalesa sipas planifikimit të mëhershëm në paragrafë. Pyetjet parashtrohen pas çdo ndalese të njësisë, lidhur me atë se çfarë kanë lexuar dhe çfarë mendimi kanë për pjesën që pason në tekston. Disa pyetje që mund t'i parashtrohen nxënësve pas ndalesës së parë: në bazë të asaj çfarë keni lexuar, a mund të na tregoni se si zhvilloheshin përparimet e ushtrisë osmane në Azi? Në çfarë argumentesh bazoheni? A keni ndonjë argument që mund ta vërtetoni për këtë që thoni?

Më pas vazhdohet me leximin e pjesës së dytë dhe me përfundimin e saj pasojnë pyetjet e tjera, si: si ishte gjendja e tyre në Evropë? Cilat ishin vështirësitë që hasnin gjatë fushatave ushtarake? Kështu do të vazhdohet deri te ndalesa e fundit.

### **Pjesa përfundimtare:**

Në përmbyllje me teknikën *Turi i galerisë*, nxënësit udhëzohen të punojnë në reflektim një shkrim të lirë sipas vullnetit të tyre, në lidhshmëri me temën. Pasi të përfundojnë, punimet vendosen në muret e klasës, pastaj nxënësit me radhë shkojnë dhe i shkojnë punimet, diskutojnë dhe mund t'i plotësojnë me ndonjë ide, duke shkruar në punimet e grupeve të tjera, të shkruajnë ndonjë koment, etj. Në fund grupet marrin punimet e tyre, i rishikojnë dhe i krahasojnë me punimet e tjera, i lexojnë komentet e marra nga të tjërët etj.

### **Aktivitete shtesë:**

Nxënësit diskutojnë për qytetërimin e Perandorisë Osmane.

### **Vlerësimi:**

Vlerësimi i vazhdueshëm;

Vlerësimi individual dhe në grup;

Vlerësim i bashkëpunimit në grup.

## 23. POPUJT BALLKANIKË GJATË SHEKUJVE XVI-XVIII

|   |                          |   |                    |
|---|--------------------------|---|--------------------|
| Fusha kurrikulare:<br><b>Shqëria dhe Mjedis</b> | Lënda:<br><b>Histori</b> | Shkalla e kurrikulës:<br><b>Shkalla 4</b> | Klasa:<br><b>8</b> |
|---|--------------------------|---|--------------------|

**RNF:** 1.1. Analizon çështjet shoqërore, ekonomike, kulturore e arsimore që ndikojnë në individë dhe bashkësi, si dhe argumenton ndikimin e veprimeve të njeriut në mjedis.

**RNSH:** Kompetenca I – 2, 3. II – 1.

### Rezultatet e të nxënëtit të lëndës:

**Nxënësi/ja:** Shpjegon ngritjen e sistemit administrativ osman në trevat arbërore dhe identifikon faktorët që ndikuan në ndryshimin e strukturës fetare të arbërve/shqiptarëve.

Analizon shkaqet e kryengritjeve arbërore/shqiptare kundër pushtetit osman dhe vlerëson bashkëpunimin e popujve të Ballkanit për çlirim.

**Kriteri i suksesit:** kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë;

**Fjalë kyçe:** osmanët, Ballkani, ejaleti, feudalët, luftërat, betejat;

**Burimet:** libri, harta gjeografike, harta historike;

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:** gjeografi.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

### Pjesa hyrëse:

Në këtë fazë të orës mësimdhënësi/ja i udhëzon nxënësit të bëjnë një shkrim të lirë me temën *Popujt e Ballkanit*. Disa nga krijimet e nxënësve lexohen në klasë; mund të ketë edhe diskutime plotësuese nga nxënësit e tjerë.


### Pjesa kryesore:

Këtë fazë të orës mësimore, mësimdhënësja/i vazhdon me teknikën *Intervista me tre hapa*.

Përmes kësaj teknike bashkëpunuese, nxënësit e intervistojnë njëri-tjetrin. Mësimdhënësi/ja i udhëzon nxënësit të formohen në grupe nga katër antarë, të cilët kanë për detyrë që njësinë mësimore ta lexojnë në paragrafë. P.sh.: paragrafin e parë e lexojnë të gjithë anëtarët e grupit, por partneri A e interviston partnerin B (d.m.th. A-ja është intervistuesi, ndërsa B-ja është i intervistuarit). Ndërsa partneri C e interviston partnerin D. Gjatë leximit, partnerët i ndërrojnë rolet, duke qenë herë të intervistuar e herë intervistues. Ky proces vazhdon gjatë tërë kohës, duke intervistuar partnerët njëri-tjetrin gjer në fund të njësisë mësimore.

### Pjesa përfundimtare:

Në këtë fazë nxënësit përmes kllasterit reflektojnë nga ajo çfarë kanë lexuar, fillimisht në mënyrë individuale e më pas në çifte dhe grup. Idetë e prezantuara mësimdhënësi/ja i paraqet në tabelë. Duke marrë mendime të ndryshme nga nxënësit, mësimdhënësja/i të bëjë një degëzim sa më të zgjeruar të kllasterit me informacione të shumta.



### Aktivitete shtesë:

Mësimdhënësi/ja i udhëzon nxënësit/et ta përgatitin në PowerPoint përbajtjen e kësaj njësie mësimore, duke përdorur teknologjinë informative të komunikimit për nevoja pedagogjike.

### Vlerësimi:

Vlerësimi për angazhim individual;

Vlerësimi për bashkëpunim dhe respektim në grup;

Vlerësimi për cilësinë e punimeve;

Vlerërimi për përdorimin e TIK-ut për nevoja pedagogjike.

## VIII. FORMIMI I SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS

### 24. KOLONITË ANGLEZE NË AMERIKËN E VRIUT

|  |                          |   |                    |
|--|--------------------------|---|--------------------|
| Fusha kurrikulare:<br><b>Shoqëria dhe Mjedis</b> | Lënda:<br><b>Histori</b> | Shkalla e kurrikulës:<br><b>Shkalla 4</b> | Klasa:<br><b>8</b> |
|--|--------------------------|---|--------------------|

**RNF:** 2.1. Krahason ngjarjet shoqërore, historike, politike, ekonomike e kulturore, si dhe dukuritë (fenomenet) natyrore e mjedisore, shpjegon shkaqet dhe pasojat e tyre, si edhe ndikimin që kanë ato në jetën e njerëzve.  
2.2. Shpjegon përbërjen e gjeosferës, si dhe analizon rolin e resurseve natyrore në mjedisin dhe në zhvillimin ekonomik të një vendi, rajoni, shteti apo kontinenti.

**RNSH:** Kompetenca  
I – 1, 2, 5.

#### Rezultatet e të nxënët të lëndës::

**Nxënësi/ja:** shpjegon ndryshimet në rafshin ekonomik, kulturor dhe politik në “tokat e reja” si rrjedhojë e kolonizimit evropian.

Identifikon krijimin e kolonive të para evropiane dhe vlerëson efektet e tyre për banorët indigjen.

Shpjegon fenomenin e skllavërisë dhe debaton për shtrirjen e këtij fenomeni.

**Kriteri i suksesit:** kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë;

**Fjalë kyçe:** koloni angleze, Amerika, holandezët, Nju Jorku, dallimet shoqërore, skllevërit, popullsia indiane;

**Burimet:** libri, foto, harta gjeografike, harta historike;

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:** gjeografi, ekonomi.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

### Pjesa hyrëse:

Mësimdhënësi/ja e fillon orën me pyetjet: çfarë dini për Anglinë? Çfarë kuptoni me fjalën koloni? Cilat ishin kolonitë e para të Anglisë? Cilat ishin kolonitë e para të Anglisë në kontinentin e Amerikës? Cila është arsyja e kolonizimit të vendeve? Përgjigjet e marra nga nxënësit shënohen në tabelë, njëherazi kërkohet edhe nga nxënësit që në fletoret e tyre t'i shënojnë përgjigjet.

### Pjesa kryesore:

Në këtë fazë të orës mësimore përdoret teknika *Fleta e ekspertit*. Mësimdhënësi/ja paraprakisht e ndan njësinë mësimore në katër pjesë dhe më pas i udhëzon nxënësit që ta mësojnë pjesën që u është caktuar. Ecuria më pastaj vazhdon: mësimdhënësja/i i ndan nxënësit në grupe familjare, të cilët caktohen me numra nga 1 deri në 4. Të gjithë nxënësit e caktuar me numrin një bashkohen në një grup të përbashkët, dyshet në grup tjetër e kështu me radhë, të cilët, në bazë të udhëzimeve, e mësojnë në grup tërë njësinë mësimore, për t'i gjetur përgjigjet e pyetjeve të parashtruara nga mësimdhënësi/ja. Pyetjet janë të përfshira nga e tërë njësia mësimore, në mënyrë që nxënësit të lexojnë jo vetëm një pjesë, por komplet njësinë. P.sh.: për grupin e parë pyetjet mund të jenë: 1) Me cilat vende evropiane u ndeshën anglezët për kolonitë e tyre në kontinentin e Amerikës? 2) Cilat prodhime eksportoheshin nga Amerika në Evropë? Pyetjet formulohen të ndryshme dhe për të gjitha grupet. Të gjithë nxënësit e caktuar në grupet e tyre e mësojnë në bashkëpunim njësinë, që më pas të reflektojnë te grupet e tyre familjare. Duke u nisur nga pjesa e parë, vetë nxënësit do t'ua shpjegojnë nxënësve të tjerë pjesëzën e mësuar. Për ta kuptuar sa më mirë pjesën e njësisë mësimore, nxënësit parashtrojnë pyetje të ndryshme. Mësimdhënësi/ja formulon pyetje sipas nevojave të klasës dhe sipas niveleve të nxënësve.

### Pjesa përfundimtare:

Në këtë fazë të orës mësimore, mësimdhënësja/i i udhëzon nxënësit që të shkruajnë një ese, për t'i paraqitur të gjitha njohuritë e fituara gjatë periudhës së realizim të kuptimit, për kolonizimin dhe tregtinë me njerëz (skllevërit të sjellë nga Afrika në Amerikë.

### Aktivitete shtesë:

Nxënësit diskutojnë për rezultatet e zhvillimit ekonomik të shteteve evropiane. Nxënësit i diskutojnë dhe argumentojnë mendimet e tyre.

### Vlerësimi:

Vlerësim për bashkëpunim në grup;  
Vlerësim për pjesëmarje aktive në diskutim.

## 25. SHPALLJA E PAVARËSISË SË ShBA-së

|   |                          |   |                    |
|---|--------------------------|---|--------------------|
| Fusha kurrikulare:<br><b>Shqëria dhe Mjedis</b> | Lënda:<br><b>Histori</b> | Shkalla e kurrikulës:<br><b>Shkalla 4</b> | Klasa:<br><b>8</b> |
|---|--------------------------|---|--------------------|

**RNF:** 2.2. Shpjegon përbërjen e gjeosferës, si dhe analizon rolin e resurseve natyrore në mjedisin dhe në zhvillimin ekonomik të një vendi, rajoni, shteti apo kontinenti.

**RNSH:** Kompetenca I – 2, 5. II – 2, 7.

### Rezultatet e të nxënëtit të lëndës:

**Nxënësi/ja:** identifikon shkaqet e Revolucionit Kombëtar Amerikan dhe shqyrton rezultatin dhe ndikimin e tij.

**Kriteri i suksesit:** kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë;

**Fjalë kyçe:** kolonitë, shpallja, anglezët, amerikanët, çaji, qeveria angleze;

**Burimet:** libri, harta gjeografike, harta historike;

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:** ed.qytetare.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

### Pjesa hyrëse:

Mësimdhënësi/ja në këtë fazë të orës e përdor teknikën *Parashikim me terma paraprakë*. Mësimdhënësi/ja i shkruan në tabelë termat: pavarësi, luftë, ndarje, ndikim, ekonomi, tregti. Me këto terma i udhëzon nxënësit të krijojnë një histori të shkurtër. Pasi të përfundojnë, nxënësit në mënyrë individuale i lexojnë krijimet e tyre.

### Pjesa kryesore:

Mësimdhënësi/ja njësinë mësimore e ndan në tri pjesë dhe më pas i udhëzon nxënësit që t'i mësojnë sipas këtyre nëntitujve:

- 1) *Prishja e marrëdhënieve të kolonëve me kolonizatorët;*
- 2) *Problemi i çajit dhe fillimi i luftës për pavarësi;*
- 3) *Shpallja e Pavarësisë së ShBA-së.*

Pas ndarjes së njësisë mësimore në tri pjesë (nëntituj) mësimdhënësi/ja i ndan nxënësit në grupe familjare (të cilët do të caktohen me numra nga 1 deri në 3). Të gjithë nxënësit e caktuar me numrin një bashkohen në një grup të përbashkët, dyshet në grup tjetër e kështu me radhë, të cilët në bazë të udhëzimeve e mësojnë në grup pjesën e caktuar nga mësimdhënësi/ja. Të gjithë këta nxënës, të caktuar në grupet e tyre, duke bashkëpunuar e mësojnë njësinë sa më mirë, që më pas të reflektojnë te grupet e tyre familjare. Duke u nisur nga pjesa e parë, vetë nxënësit do t'ua

shpjegojnë nxënësve të tjerë pjesëzën e mësuar. Për ta kuptuar sa më mirë pjesën e njësisë mësimore, nxënësit parashtronjë pyetje të ndryshme. Ky proces vazhdon derisa të përfundohet e tërë njësia mësimore.

### Pjesa përfundimtare

Mësimdhënësi/ja e shkruan në tabelë (dërrasë të zezë) emrin e temës apo një emër që ka të bëjë me këtë temë. Meqenëse në këtë njësi mësimore kemi të bëjmë me prishjen e mardhënieve (luftën) në mes kolonizatorëve dhe kolonëve, atëherë si temë do ta marrim temën “Pavarësia”. Fjalën pavarësi, mësimdhënësi/ja e shkruan në tabelë, njëjtë veprojnë edhe nxënësit. Ecuria e teknikës është si në vijim:

- |               |           |
|---------------|-----------|
| 1.            | Pavarësia |
| 2. dy mbiemra | _____     |
| 3. tri folje  | _____     |
| 4. një fjali  | _____     |
| 5. sinonimi   | _____     |

### Aktivitete shtesë:

Diskutim: A do të isha ndryshe, sikur të rritesa në një kulturë tjeter?

### Vlerësimi:

Vlerësim formativ;  
Vlerësim në komunikim;  
Vlerësim në bashkëpunim në grup dhe individual.

## IX. REVOLUCIONI INDUSTRIAL

### 26. ZHVILLIMET TEKNOLOGJIKE DHE REVOLUCIONI INDUSTRIAL NË ANGLI

|  |                          |   |                    |
|--|--------------------------|---|--------------------|
| Fusha kurrikulare:<br><b>Shoqëria dhe Mjedis</b> | Lënda:<br><b>Histori</b> | Shkalla e kurrikulës:<br><b>Shkalla 4</b> | Klasa:<br><b>8</b> |
|--|--------------------------|---|--------------------|

**RNF:** 2.2. Shpjegon përbërjen e gjeosferës, si dhe analizon rolin e resurseve natyrore në mjedisin dhe në zhvillimin ekonomik të një vendi, rajoni, shteti apo kontinenti.

5.1. Prezanton shembuj se si një individ dhe si një anëtar i një grupei, mund të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm (ruajtjen e resurseve, riciklimin e materialeve) në harmoni me ruajtjen e mjedisit dhe të biodiversitetit.

**RNSH:** Kompetenca  
I – 2, 5. II – 2. III – 1.

#### Rezultatet e të nxënësit të lëndës::

**Nxënësi/ja:** identifikon të arriturat kryesore shkencore në periudhën moderne dhe ndikimet e tyre në shoqëri.

Identifikon shpikjet kryesore që çuan në Revolucionin Industrial.

Identifikon anët pozitive të avancimit inxhinieriko-teknologjik, si dhe ndikimet negative në mjedisin jetësor.

Shpjegon ndikimet e revolucionit industrial dhe të zhvillimeve shkencore-teknike në jetën e përditshme të njerëzve.

**Kriteri i suksesit:** kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë;

**Fjalë kyçe:** Anglia, revolucioni, industria, makinat, prodhimi;

**Burimet:** libri, foto, interneti;

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:** TIK, sociologji.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

### Pjesa hyrëse:

Mësimdhënësi/ja fillimisht i shënon në tabelë disa fjalë kyçe, prej të cilave kërkon që nxënësit të shkruajnë një tregim të shkurtër me ato fjalë. Fjalët kyçe mund të janë: borgjezi, Xhejms Vat, shpikje, makinë me avull, revolucion industrial, ekonomi, prodhim,jeta shoqërore, etj. Pasi t'i krijojnë tregimet, disa nxënës lexojnë para të gjithë klasës.

### Pjesa kryesore:

Mësimdhënësi/ja paraprakisht e ndan njësinë mësimore në katër pjesë, siç janë:

1) *Anglia në prag të revolucionit;*

- 2) *Shpikjet në prodhimin e tekstit;*
- 3) *Xhejms Vati e zbuloi makinën me avull;*
- 4) *Reflektimi i revolucionit industrial në jetën e njerëzve.*

Pas ndarjes së njesisë, mësimdhënësi/ja i ndan nxënësit në grupe familjare, të cilat caktohen me numra (1-4). Të gjithë nxënësit e caktuar me numrin një, bashkohen në një grup të përbashkët, dyshet në grup tjetër e kështu me radhë, të cilët, në bazë të udhëzimeve, e mësojnë në grup pjesën e caktuar nga mësimdhënësi/ja. Të gjithë këta nxënës/e të caktuar në grupe, në bashkëpunim e mësojnë njësinë sa më mirë dhe më pas reflektojnë te grupet e tyre familjare.

Duke u nisur nga pjesa e parë, vetë nxënësit ua shpjegojnë nxënësve të tjerë pjesëzat e mësuara, ashtu siç janë të renditura në tekst. Për ta kuptuar sa më mirë pjesën e njësisë mësimore, nxënësit parashtrojnë pyetje të ndryshme. Ky proces vazhdon derisa të përfundohet e tërë njësia mësimore.

#### **Pjesa përfundimtare:**

Fazën përfundimtare e përmbyllim me pyetjet:

- 1) Identifikoni shpikësit kryesorë dhe makinat e tyre.
- 2) Krahasoni prodhimin para dhe pas shpikjes së makinave.
- 3) Si ndikoi revolucioni industrial në jetën e njerëzve.

Nxënësit reflektojnë në mënyrë individuale.

#### **Aktivitete shtesë:**

Secili grup ka për detyrë të shkruajë një ese me temën *Profesioni juaj i preferuar*. Nxënësit më pas i lexojnë esetë.

#### **Vlerësimi:**

Vlerësimi formativ;

Vlerësimi i nxënësve në angazhimin në grup;

Vlerësim individual i nxënësve.

## X. FORMIMI I PASHALLËQEVE SHQIPTARE

### 27. PASHALLËKU I SHKODRËS

|  |                          |   |                    |
|--|--------------------------|---|--------------------|
| Fusha kurrikulare:<br><b>Shoqëria dhe Mjedis</b> | Lënda:<br><b>Histori</b> | Shkalla e kurrikulës:<br><b>Shkalla 4</b> | Klasa:<br><b>8</b> |
|--|--------------------------|---|--------------------|

**RNF:** 1.1 Analizon çështjet shoqërore, ekonomike, kulturore e arsimore që ndikojnë në individë dhe bashkësi, si dhe argumenton ndikimin e veprimeve të njeriut në mjedis.

**RNSH:** Kompetenca  
II – 1, 5. III – 2.

#### Rezultatet e të nxënësit të lëndës:

**Nxënësi/ja:** shpjegon procesin e formimit të pashallëqeve shqiptare dhe shqyrton raportin e tyre me Perandorinë Osmane dhe fuqitë e mëdha të kohës.

**Kriteri i suksesit:** kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë;

**Fjalë kyçe:** pashallëku, Shkodra, Bushatlinjtë, Mehmeti dhe Karamahmuti;

**Burimet:** libri, fotografitë, interneti;

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:** gjeografi.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

### Pjesa hyrëse:

Në këtë fazë të orës mësimore, mësimdhënësi/ja e përdor teknikën *Stuhi mendimesh*. Së pari fillon me pyetje që i nxisin dhe i motivojnë nxënësit për mësim. Mësimdhënësi/ja i parashtron pyetjet: 1 Kur është krijuar Pashallëku i Shkodrës? 2 Çfarë ndikoi për krijimin e pashallëqeve? 3 A njihni ndonjë figurë të rëndësishme të këtij pashallëku?

### Pjesa kryesore:

Realizimin e kuptimit e vazhdojmë me teknikën *DLTA*, me të cilën mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit të përgjigjen në pyetjet që do t'u parashtrojë, pas çdo ndalese. Meqenëse njësia mësimore përbëhet nga tri pjesë (nëntituj, atëherë mësimdhënësi/ja njësinë e ndan në tri pjesë dhe pas çdo përfundimi të nëntitullit, u parashtron pyetje në lidhje me atë se çfarë kanë dëgjuar dhe çfarë mendimi kanë lidhur me pjesën që pason në tekst. Tekstin e lexon vetë mësimdhënësi/ja apo kërkon nga ndonjë nxënës që ta lexojë, i cili lexon bukur dhe rrjedhshëm. Pas ndalesës së parë, mësimdhënësi/ja i parashtron këto pyetje: cilat familje feudale shqiptare pretendonin të bëheshin sundimtarë të pashallëkut? Cila ishte arsyja që hynë në konflikt? A keni ndonjë argument? A i kishte ndihmuar Porta e Lartë? Në çka bazoheni?

Pastaj vazhdojmë me pjesën e dytë dhe pas përfundimit parashtrohen pyetjet që lidhen me këtë pjesë të tekstit. Kështu vazhdohet pas çdo pjesë të lexuar gjë fund të njësisë mësimore.

**Pjesa përfundimtare:**

Nxënësit së pari në ndahen në dyshe, më pastaj në grup dhe diskutojnë për pjesën që e kanë lexuar, pastaj diskutojnë për informacione të reja dhe në fund nxjerrin përfundime.

Mësimdhënësi/ja angazhon një anëtar të grupit, për t'i dhënë përfundimet e nxjerra gjatë bashkëbisedimit.

**Aktivitete shtesë:**

Nxënësit e lexojnë në mënyrë individuale njësinë mësimore. Pasi ta lexojnë, secili grup e bën përzgjedhjen e një nxënësi, i cili ka për detyrë që të bëjë intervista në grup në raport me njësinë.

**Vlerësimi:**

Nxënësit vlerësohen për angazhim individual dhe grupor;

Nxënësit vlerësohen për gatishmëri dhe bashkëpunim në grup;

Nxënësit vlerësohen në komunikim.

## 28. PASHALLËKU I JANINËS

|   |                          |   |                    |
|---|--------------------------|---|--------------------|
| Fusha kurrikulare:<br><b>Shqëria dhe Mjedis</b> | Lënda:<br><b>Histori</b> | Shkalla e kurrikulës:<br><b>Shkalla 4</b> | Klasa:<br><b>8</b> |
|---|--------------------------|---|--------------------|

**RNF:** 1.1. Analizon çështjet shoqërore, ekonomike, kulturore e arsimore që ndikojnë në individë dhe bashkësi, si dhe argumenton ndikimin e veprimeve të njeriut në mjedis.

**RNSH:** Kompetenca II – 1, 5. III – 2.

### Rezultatet e të nxënëtit të lëndës:

**Nxënësi/ja:** shpjegon procesin e formimit të pashallëqeve shqiptare dhe shqyrton raportin e tyre me Perandorinë Osmane dhe fuqitë e mëdha të kohës.

**Kriteri i suksesit:** kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë;

**Fjalë kyçë:** pashallëku, Ali Pasha, Janina, Sulltani, tradhtia, Masakra e Manastirit, Porta e Lartë;

**Burimet:** libri, interneti, harta gjeografike, harta historike;

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:** gjeografi, arkeologji, art.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

### Pjesa hyrëse:

Në këtë fazë do ta zbatojmë teknikën Stuhi mendimesh, duke filluar me pyetjet që nxisin dhe motivojnë për orën mësimore. Mësimdhënësi/ja fillon me pyetje, si: a mund të më tregoni kur ishte krijuar Pashallëku i Shkodrës? Çfarë ndikoi për krijimin e pashallëqeve? A dini ndonjë figurë të rëndësishme të këtij pashallëku? Kështu mësimdhënësi/ja mund ta fillojë orën mësimore, duke drejtuar përmes pyetjeve rrëth temës e cila do të zhvillohet. Pyetjet mund t'i përzgjedhë vetë mësimdhënësi/ja, për ta nxitur kureshtjen për leximin e temës mësimore.

### Pjesa kryesore:

Më pas do të vazhdojmë me teknikën DRTA, me të cilën mësimdhënësi/ja u drejtohet nxënësve me udhëzimet për të lexuar me vëmendje, pasi do të përgjigjen në pyetjet që do t'i parashtrojë pas çdo ndalese. Meqë njësia mësimore përbëhet nga tre nëntituj, atëherë mësimdhënësi/ja njësinë mund ta ndajë në tri pjesë apo pas çdo përfundimi të nëntitullit, u parashtron pyetje në lidhje me atë se çfarë kanë lexuar dhe çfarë mendimi kanë lidhur me pjesën që pason në tekston. Pyetjet që do të mund të ndihmonin për t'i motivuar nxënësit për të mësuar, p.sh. pas ndalesës së parë, janë: si u lejua nga Porta e Lartë që një kaçak të bëhej sundimtar i një pashallëku? Si arriti Ali Pasha ta fitonte besimin e Portës së Lartë? A keni ndonjë argument? A kishte premtuar Aliu bindje ndaj Portës së Lartë? Në çka bazoheni? Pastaj, vazhdojmë me pjesën e dytë dhe pas përfundimit pasojnë pyetjet që lidhen me këtë pjesë të tekstit. Kështu vazhdohet pas çdo pjese të lexuar gjë fund të njësisë mësimore.

**Pjesa përfundimtare:**

Nxënësit së pari të ndahan në dyshe, më pastaj në grup diskutojnë për pjesën që e kanë lexuar, pastaj diskutojnë për informacione të reja dhe më në fund nxjerrin përfundime. Mësimdhënësi/ ja do të angazhojë një anëtar të grupeve, për t'i dhënë përfundimet e nxjerra gjatë bashkëbisedimit.

**Aktivitet shtesë**

Nxënësit në mënyrë individuale udhëzohen që të bëjnë projekt për prezantim në klasë.

**Vlerësimi:**

Nxënësit vlerësohen për punën individuale;

Nxënësit vlerësohen për angazhimin e tyre;

Nxënësit vlerësohen për cilësinë e prezantimit.

## XI. FRANCA NË KOHËN E NAPOLEON BONAPARTËS

### 30. FRANCA NË KOHËN E DREJTORATIT DHE TË PERANDORISË

|   |                          |   |                    |
|---|--------------------------|---|--------------------|
| Fusha kurrikulare:<br><b>Shoqëria dhe Mjedisë</b> | Lënda:<br><b>Histori</b> | Shkalla e kurrikulës:<br><b>Shkalla 4</b> | Klasa:<br><b>8</b> |
|---|--------------------------|---|--------------------|

**RNF:** 2.1 Krahason ngjarjet shoqërore, historike, politike, ekonomike e kulturore, si dhe dukuritë (fenomenet) natyrore e mjedisore, shpjegon shkaqet dhe pasojat e tyre dhe ndikimin që kanë ato në jetën e njerëzve.

**RNSH:** Kompetenca  
II – 2, 7. IV – 1, 7.

#### Rezultatet e të nxënësit të lëndës::

**Nxënësi/ja:** analizon rrethanat e ngritjes së Napoleonit në krye të Francës dhe shqyrton në mënyrë kritike kurorëzimin e tij si perandor.

**Kriteri i suksesit:** kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë;

**Fjalë kyçe:** skena politike, derjtorati, Napoleon Bonaparta, perandoria, lufta, bllokada kontinentale;

**Burimet:** libri, foto, harta gjeografike, harta historike;

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:** gjeografi, ed.qytetare.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

### Pjesa hyrëse:

Mësimdhënësi u drejtohet nxënësve me pyetjet: nën sundimin e kujt gjendej Franca në fundfillim të shek. XVIII - XIX? A njihnin ndonjë perandor? Si erdhi në pushtet? Cilat ishin synimet e Napoleon Bonapartës? Derisa nxënësit të reflektojnë, mësimdhënësi/ja i paraqet idetë e tyre në tabelë, po ashtu edhe nxënësit marrin shënimë në fletore.

### Pjesa kryesore:

Në vijim do të kërcohët nga nxënësit ta lexojnë në mënyrë individuale njësinë e ndarë në pjesë, e cila mund të shfrytëzohet sipas nëntitujve apo sythave të njësisë mësimore. Pas leximit të pjesëzës, nxënësit do të bashkëbisedojnë në çifte dhe më pas së bashku me tërë klasën do të reflektojnë duke diskutuar apo duke zhvilluar një mësimdhënie interaktive për atë çfarë kanë nxënë. Ecuria e punës vazhdon kështu me radhë derisa të përfundojë e tërë njësia mësimore.

**Pjesa përfundimtare:**

Në këtë fazë do të kërkohet nga nxënësit të reflektojnë në mënyrë individuale në fletoret e tyre, duke paraqitur një degëzim përmes teknikës *Kllaster* rrëth njësisë mësimore. Pasi të përfundojnë, kërkohet nga të gjithë të paraqesin atë se çfarë kanë zënë gjatë kësaj ore mësimore. Mësimdhënësi duhet t'i shënojë të gjitha idetë e nxënësve në tabelë, pasi e gjithë kjo ndihmon në të nxënët në bashkëpunim.

**Aktivitete shtesë:**

Mësimdhënësi/ja i udhëzon nxënësit/et ta përgatisin në PowerPoint përbajtjen e kësaj njësie mësimore, duke e përdorur teknologjinë informative të komunikimit për nevoja pedagogjike.

**Vlerësimi:**

Nxënësit vlerësohen për angazhim individual;

Nxënësit vlerësohen për dhënien e ideve;

Nxënësit vlerësohen për angazhimin e tyre në përdorimin e TIK-ut për nevoja pedagogjike.

## 31. ZHVILLIMI DHE RËNIA E PERANDORISË SË NAPOLEON BONAPARTËS

|   |                          |   |                    |
|---|--------------------------|---|--------------------|
| Fusha kurrikulare:<br><b>Shqëria dhe Mjedis</b> | Lënda:<br><b>Histori</b> | Shkalla e kurrikulës:<br><b>Shkalla 4</b> | Klasa:<br><b>8</b> |
|---|--------------------------|---|--------------------|

**RNF:** 2.1 Krahason ngjarjet shoqërore, historike, politike, ekonomike e kulturore, si dhe dukuritë (fenomenet) natyrore e mjedisore, shpjegon shkaqet dhe pasojat e tyre dhe ndikimin që kanë ato në jetën e njerëzve.

**RNSH:** Kompetenca  
I – 1. II – 2. VI - 2

### Rezultatet e të nxënët të lëndës:

**Nxënësi/ja:** radhit pushtimet e Francës në Evropë dhe jashtë saj dhe analizon ndikimin e tyre në jetën shoqërore e politike.

**Kriteri i suksesit:** kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë;

**Fjalë kyçë:** perandoria, Napoleon Bonaparta, lufta, koalicioni antifrancez, humbja e Napoleonit, internimi;

**Burimet:** libri, foto, harta gjeografike, harta historike;

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:** gjeografi.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

### Pjesa hyrëse:

Në këtë fazë të evokimit mund të përdoret teknika *Parashikim nëpërmjet fjalëve kyçë*. Kjo teknikë është e përshtatshme për lidhjen emocionale të nxënësit me njësinë e re mësimore. Ecuria është si vijon: caktohen disa fjalë që përdoren brenda mësimit dhe që i bëjnë kureshtarë nxënësit përmajtjen e njësisë së re. Fjalët kyçë të mësimit mund të janë: fuqizim, luftë, Napoleon Bonaparta, Rusi, ushtri, humbje, internim, Shën Helenë. Me këto fjalë kyçë nxënësit thurin një ngjarje. Më pas nxënësit në dyshe i shkëmbijnë ngjarjet e thurura apo lexohen disa nga këto krijime të nxënësve para gjithë klasës.

### Pjesa kryesore:

Në këtë fazë të mësimit, mësuesi/ja u tregon nxënësve se çka do të lexojnë dhe gjatë leximit ata do të marrin shënimë. Më pas u tregohet që fleta të ndahet në mes me një vijë vertikale. Më pas gjatë leximit, në të majtë të faqes shkruajnë ndonjë mesazh apo citat nga teksti (pjesa që u bën përshtypje), ndërsa në anën e djathtë duhet të shkruhen komentet: pse jeni përcaktuar për atë citat? Çfarë ju bëri përshtypje? Çfarë pyetjesh keni? (komenti përshtypje). Të njëjtin lexim e bën edhe mësimdhënësi/ja. Në fund të leximit kërkojen vullnetarë (2-3 veta që t'i japid).

komentet e tyre. Pas leximit të pjesës që u ka bërë përshtypje, vullnetarët pyeten: Pse jua térhoqi vëmendjen kjo pjesë? Çka ju béri të mendoni? Po ashtu, pyetet nëse ka ndonjë tjetër që e ka zgjedhur të njëjtën pjesë dhe nëse ka ndonjë arsy që e ka zgjedhur atë pjesë. Në fund mësimdhënësi/ja i jep komentet e saja/tij të nxjerra gjatë leximit që ai/ajo ka bërë. Në fund shtrohen pyetjet: çfarë do të mbani mend nga ky material? Cili është mesazhi më i rëndësishëm?

### **Pjesa përfundimtare:**

Për t'i nxitur nxënësit që të diskutojnë përmbytjet mësimore që i mësuant gjatë realizimit të kuptimit, mësimdhënësja në dërrasën e zezë formon një skemë, duke u bazuar në ulëset e nxënësve. Bëhet një pyetje nga mësimdhënësi/ja. Nxënësit ftohen që për dy minuta të shkruajnë përgjigje individuale. Pas dy minutash ftohen nxënësit që t'i japin idetë e tyre. Nëse ka përgjigje të kundërt nga dy nxënës, atëherë ftohet një nxënës i tretë që ta japë mendimin e tij se me cilën përgjigje pajtohet dhe përse pajtohet. Nga nxënësi kërkohet ta argumentojë përgjigjen. Mësimdhënësi/ja nuk jep vetë përgjigje dhe nuk përkrah një mendim kundrejt tjetrit. Me këtë ecuri vazhdohet edhe me pyetje të tjera.

### **Aktivitete shtesë:**

Nxënësit/et udhëzohen t'i integrojnë mediat, duke përdorur TIK-un për të hulumtuar për Napoleon Bonapartën.

### **Vlerësimi:**

Nxënësit vlerësohen për angazhim individual;  
Nxënësit vlerësohen për përdorim të drejtë të TIK-ut;  
Nxënësit vlerësohen për cilësinë e prezantimeve.

## 32. KONGRESI I VJENËS DHE ALEANCA E SHENJTË

|   |                          |   |                    |
|---|--------------------------|---|--------------------|
| Fusha kurrikulare:<br><b>Shqëria dhe Mjedis</b> | Lënda:<br><b>Histori</b> | Shkalla e kurrikulës:<br><b>Shkalla 4</b> | Klasa:<br><b>8</b> |
|---|--------------------------|---|--------------------|

**RNF:** 2.1. Krahason ngjarjet shoqërore, historike, politike, ekonomike e kulturore, si dhe dukuritë (fenomenet) natyrore e mjedisore, shpjegon shkaqet dhe pasojat e tyre, si edhe ndikimin që kanë ato në jetën e njerëzve.

2.2. Shpjegon përbërjen e gjeosferës, si dhe analizon rolin e resurseve natyrore në mjedisin dhe në zhvillimin ekonomik të një vendi, rajoni, shteti apo kontinenti.

**RNSH:** Kompetenca  
I – 6. II – 2, 5

### Rezultatet e të nxënëtit të lëndës::

**Nxënësi/ja:** shqyrton vendimet e Kongresit të Vjenës dhe gjykon ndikimin e tyre në restaurimin e sistemit konservativ (Aleanca e Shenjtë).

Evidenton kontradiktat midis fuqive evropiane për sferat e interesit në botë dhe përkufizion ekspansionin kolonialist të tyre.

**Kriteri i suksesit:** kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë;

**Fjalë kyçë:** kongres, diplomatët, shtetet e mëdha, pretendime, vendime, ekuilibër, konfederatë, Aleancë e Shenjtë.

**Burimet:** libri, harta, foto, interneti;

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:** gjeografi.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

### Pjesa hyrëse:

Në këtë fazë të orës mësimore, mësimdhënësja/i e përdor teknikën *Stuhi mendimesh*, duke i pyetur nxënësit/et: çfarë dinë për Vjenën e sotme? Ku gjendet? Kryeqytet i cilit shtet është? Me cilat shtete kufizohet? Me çfarë kulture karakterizohet? etj. Të gjitha përgjigjet e nxënësve shënohen në tabelë. Nxënësve u jepet mundësia që edhe ata të bëjnë pyetje të ndryshme për qytetin e Vjenës dhe njohuritë që kanë për të.

### Pjesa kryesore:

Në këtë fazë të orës mësimore, mësimdhënësja i udhëzon të gjithë nxënësit ta lexojnë në mënyrë individuale pjesën e parë (paragrafin e parë) *Kongresi i Vjenës, shtator 1814 - qershori 1815*. Pasi ta lexojnë, mësimdhënësja/i fillon të parashtrojë pyetje të ndryshme në lidhje me këtë temë. P.sh.: çfarë shqyrtuan diplomatët të cilët ishin mbledhur në Vjenë, në vitin 1814? Pas përgjigjeve në pyetje, mësimdhënësja kërkon nga nxënësit/et që ta lexojnë paragrafin tjetër të njësisë me titull

*Formimi i Aleancës së Shenjtë.* Mësimdhënësja/i parashtron pyetje të ndryshme, p.sh.: cili ishte qëllimi i formimit të Aleancës së Shenjtë? Ecuria e zhvillimit të kësaj faze mësimore vazhdon njëjtë edhe me paragrafin e fundit: *Kryengritjet në Evropë në vitet '20 të shek. XIX.*

### **Pjesa përfundimtare:**

Në këtë fazë të orës mësimore, mësimdhënësja/i ua parashton nxënësve pyetjen: si i vlerësoni kryengritjet e zhvilluara në Evropë në vitet '20 të shek. XIX? Të githë nxënësit që kanë vlerësim pozitiv, i ndan në njërin anë, ndëra nxënësit që jasin përgjigje negative, ndahanë në anën tjetër. Nxënësit udhëzohen që t'i argumentojnë përgjigjet e tyre.

### **Aktivitete Shtesë:**

Nxënësit/et diskutojnë për *Aleancën e Shenjtë*, rolin dhe veprimtarinë e saj.

### **Vlerësimi:**

Vlerësimi i vazhdueshëm;

Vlerësim në bashkëpunim në grup;

Vlerësim individual;

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje në diskutim.

## XII. EVROPA NGA 1848 DERI NË FILLIM TË SHEKULLIT XX

### 33. FRANCA DHE ANGLIA

|  |                          |   |                    |
|--|--------------------------|---|--------------------|
| Fusha kurrikulare:<br><b>Shoqëria dhe Mjedis</b> | Lënda:<br><b>Histori</b> | Shkalla e kurrikulës:<br><b>Shkalla 4</b> | Klasa:<br><b>8</b> |
|--|--------------------------|---|--------------------|

**RNF:** 2.1. Krahason ngjarjet shoqërore, historike, politike, ekonomike e kulturore, si dhe dukuritë (fenomenet) natyrore e mjedisore, shpjegon shkaqet dhe pasojat e tyre, si edhe ndikimin që kanë ato në jetën e njerëzve.  
2.2. Shpjegon përbërjen e gjeosferës, si dhe analizon rolin e resurseve natyrore në mjedisin dhe në zhvillimin ekonomik të një vendi, rajoni, shteti apo kontinenti.  
4.2. Krahason llojet e ndryshme të vendimmarjeve dikur dhe tani, si dhe reagon dhe shpreh qëndrimet e tij ndaj dukurive negative në bashkësinë ku vepron dhe në shoqëri.

**RNSH:** Kompetenca  
I – 5, 6. II - 8

#### Rezultatet e të nxënësit të lëndës:

**Nxënësi/ja:** identifikon karakteristikat kryesore të revolucioneve të vitit 1848 në Evropë. Evidenton kontradiktat midis fuqive evropiane për sferat e interesit në botë dhe përkufizón ekspansionin kolonialist të tyre.  
Vlerëson evoluimin e të drejtave qytetare dhe ndryshimin e rolit të qytetarëve në vendimarrje.

**Kriteri i suksesit:** kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë;

**Fjalë kyçe:** kushtetutë, pushtet legjislativ, republikë, çartistë, koloni;

**Burimet:** libri, interneti, harta;

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:** gjeografi.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

### Pjesa hyrëse:

Në këtë fazë të orës mësimore mësimdhënësja/i paraqet disa fjalë kyçe, siç janë: Franca, Anglia, zhvillimi ekonomik, zhvillimi politik, qeverisja. Mësimdhënësja/i kërkon nga nxënësit/et që për 5-7 minuta të shkruajnë nga një tregim apo rrëfim me këto fjalë kyçe. Disa prej nxënësve i lexojnë tregimet.

### Pjesa kryesore:

Mësimdhënësja/i i ndan nxënësit/et në tri grupe. Më pas njësinë mësimore e ndan në tri paragafe, siç janë: *Franca dhe Anglia; Qeverisja në Angli; Zhvillimi ekonomik dhe politika e*

*jashtme e Anglisë*. Grupet udhëzohen ta lexojnë komplet njësinë mësimore. Pasi ta lexojnë, mësimdhënësja kërkon nga grupi i parë që të nxjerrë pyetje nga paragrafi i parë, *Franca dhe Anglia*, për t'ua parashtruar grupeve të tjera. Grupi i dytë përgatit pyetje nga paragrafi i dytë *Qeverisja në Angli*, grupi i tretë, po ashtu, përgatit pyetje për paragrafin e tretë *Zhvillimi ekonomik dhe politika e jashtme*. Nxënësit diskutojnë për njësinë mësimore, përmes mësimdhënies interaktive.

#### **Pjesa përfundimtare:**

Në pjesën përfundimtare mësimdhënësi/ja i udhëzon nxënësit që ta vizatojnë hartën, duke i paraqitur me vija të trasha shtetin e Anglisë dhe shtetin e Francës.

#### **Aktivitete shtesë:**

Mësimdhënësja/i kërkon nga nxënësit/et që të përgatitin një projekt me temën *Franca dhe Anglia*.

#### **Vlerësimi:**

Vlerësimi i nxënësve për angazhim individual;

Vlerësimi i nxënësve për angazhim në grup;

Vlerësimi i nxënësve për angazhim në projekte;

Vlerësimi i nxënësve për performancën e tyre gjatë prezantimeve të projektit.

## 34. BASHKIMI I GJERMANISË

|   |                          |   |                    |
|---|--------------------------|---|--------------------|
| Fusha kurrikulare:<br><b>Shqëria dhe Mjedis</b> | Lënda:<br><b>Histori</b> | Shkalla e kurrikulës:<br><b>Shkalla 4</b> | Klasa:<br><b>8</b> |
|---|--------------------------|---|--------------------|

**RNF:**2.1. Krahason ngjarjet shoqërore, historike, politike, ekonomike e kulturore, si dhe dukuritë (fenomenet) natyrore e mjedisore; shpjegon shkaqet dhe pasojat e tyre dhe ndikimin që kanë ato në jetën e njerëzve.

**RNSH:**Kompetenca  
I – 1. II – 1, 5.

### Rezultatet e të nxënësit të lëndës::

**Nxënësi/ja:** identifikon karakteristikat kryesore të revolucioneve të vitit 1848 në Evropë.

Identifikon lëvizjet për krijimin e shteteve kombëtare në Evropë.

**Kriteri i suksesit:** kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë;

**Fjalë kyçe:** Gjermania, liberalët, borgjezia, Bashkimi Kombëtar, Otovon Bismarku, perandori gjerman, politika e jashtme;

**Burimet:** libri, fotografi, hulumtime në internet;

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:** sociologji, teknologji.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

### Pjesa hyrëse:

Pjesa hyrëse e orës mësimore do të zhvillohet përmes teknikës *Stuhi mendimesh*.

Mësimdhënësi do të parashtrojë pyetje rreth njohurive paraprake që mund të kenë nxënësit rrëth temës e cila do të zhvillohet gjatë orës mësimore. Pyetjet të cilat mund t'u parashtronen nxënësve janë: pas Kongresit të Vjenës, në sa shtete mbeti e copëtuar Gjermania? Për çka njihej Frankfurti në vitin 1848? Çfarë kuptojmë me fjalën liberal? Cili ishte vizioni liberal për Gjermaninë e vitit 1848? Mendimet e nxënësve shënohen në tabelë nga ana e mësimdhënësit/es, për arsyet e ndryshme: për të krijuar respekt ndaj nxënësve, për të treguar se janë të vlerësuar, për të krijuar vetëbesim te nxënësit, për të qenë përgjegjës për fjalën e thënë, për t'i motivuar dhe inkurajuar për mësim, bashkëpunim dhe komunikim.

### Pjesa kryesore:

Mësimdhënësi/ja paraprakisht e ndan njësinë mësimore në katër pjesë, siç janë: *Revolucioni i vitit 1848 në Gjermani dhe Parlamenti i Frankfurtit; Bashkimi Kombëtar; Ekonomia gjermane pas bashkimit kombëtar; Politika e jashtme dhe dorëheqja e Bismarkut*. Pas kësaj ndarjeje, mësimdhënësi/ja nxënësit i ndan në katër grupe familjare të cilët do të caktohen me numra nga 1 deri në 4. Të gjithë nxënësit/et e caktuar me numrin një bashkohen në një grup të përbashkët,

dyshet në grup tjetër, treshet me treshe e kështu me radhë, të cilët në bazë të udhëzimeve e mësojnë në grup pjesën e caktuar nga mësimdhënësi/ja. Të gjithë këta nxënës të caktuar në grupet e tyre në bashkëpunim e mësojnë njësinë sa më mirë, që më pas të reflektojnë te grupet e tyre familjare. Duke u nisur nga pjesa e parë, vetë nxënësit do t'ua shpjegojnë nxënësve të tjerrë pjesëzën e mësuar. Për ta kuptuar sa më mirë pjesën e njësisë mësimore, nxënësit parashtronjë pyetje të ndryshme. Ky proces vazhdon derisa të përfundohet e tërë njësia mësimore.

### **Pjesa përfundimtare:**

Pasi të përfundojnë në mësimnxenë, nxënësit shkruajnë një përmbledhje të shkurtër për atë se çfarë kanë mësuar (ese reflektuese). Më pas, mësimdhënësi kërkon nga nxënësit e ndarë në grupe të reflektojnë para tërë klasës për atë se çfarë kanë mësuar, por gjithnjë duke pasur kujdes që nxënësit të marrin përgjegjësi për mësimnxenë të pavarur.

### **Aktivitete shtesë:**

Mësimdhënësi/ja udhëzon secilin grup për përgatitjen e një projekti me temën “Gjermania sot”. Katër grupe përgatitin tema të ndryshme, p.sh.: grupei i parë: *Popullsia e Gjermanisë*; grupei i dytë: *Arsimi në Gjermani*; grupei i tretë: *Zhvillimet ekonomike në Gjermani* dhe grupei i katërt: *Roli i Gjermanisë në pavarësinë dhe zhvillimin e Kosovës*.

### **Vlerësimi:**

Vlerësimi i nxënësve për bashkëpunim në grup;

Vlerësimi i nxënësve për punë individuale;

Vlerësim i nxënësve për përgatitje të projekteve;

Vlerësim i nxënësve për performancën në prezantime.

## 35. BASHKIMI I ITALISË

|   |                          |   |                    |
|---|--------------------------|---|--------------------|
| Fusha kurrikulare:<br><b>Shqëria dhe Mjedis</b> | Lënda:<br><b>Histori</b> | Shkalla e kurrikulës:<br><b>Shkalla 4</b> | Klasa:<br><b>8</b> |
|---|--------------------------|---|--------------------|

**RNF:**2.1. Krahason ngjarjet shoqërore, historike, politike, ekonomike e kulturore, si dhe dukuritë (fenomenet) natyrore e mjedisore, shpjegon shkaqet dhe pasojat e tyre, si edhe ndikimin që kanë ato në jetën e njerëzve.

**RNSH:**Kompetenca  
I – 1. II – 1, 5.

### Rezultatet e të nxënësit të lëndës:

**Nxënësi/ja:** identifikon karakteristikat kryesore të revolucioneve të vitit 1848 në Evropë. Identifikon lëvizjet për krijimin e shteteve kombëtare në Evropë.

**Kriteri i suksesit:** kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë;

**Fjalë kyçe:** Italia, Piemonti, Xhuzepe Maxini, Xhuzepe Garibaldi, Viktor Emanuell II, bashkimi i Italisë, Françesko Krispi;

**Burimet:** libri, fotografitë, harta gjeografike, harta historike;

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:** sociologji, teknologji.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

### Pjesa hyrëse:

Mësimdhënësi/ja në këtë fazë të orës e përdor teknikën *Parashikim me terma paraprakë*. Mësimdhënësi e ndan tabelën në dy kolona. Në secilën kolonë shkruan nga disa terma: *kolona 1*- Italia, Piemonti, Xhuzepe, Maxini Garibaldi, ndërsa në *kolonën 2* - Emanuelli II, Bashkimi i Italisë Françesko Krispi. Në vazhdim mësimdhënësi/ja klasën e ndan në dy grupe të mëdha dhe i udhëzon që nga termat e kolonave të tyre të krijojnë një histori të shkurtër. Pasi të përfundojnë, nxënësit vullnetarisht i lexojnë krijimet e tyre.

### Pjesa kryesore:

Në vazhdim mësimdhënësi i udhëzon nxënësit ta lexojnë tekstin në mënyrë individuale, duke vendosur shenjet: shenja ✓ (tik), informacion i cili njihet nga nxënësit; shenja – (minus), informacion i cili është i ndryshëm nga informacioni që ka pasur më parë; shenja + (plus), informacion i ri dhe shenja ? (pikëpyetje), informacion i paqartë për nxënësin. Gjatë kohës që e lexojnë materialin, nxënësit vendosin shenja, më pas e plotësojnë tabelën sipas udhëzimeve të mësimdhënësit.

| ✓ | - | + | ? |
|---|---|---|---|
|   |   |   |   |

### Pjesa përfundimtare:

Në vijim të orës mësimore nxënësit lexojnë disa prej punimeve, ndërsa mësimdhënësi/ja e plotëson tabelën sipas reflektimit të nxënësve. Ndërkohë, mësimdhënësi/ja i shpjegon dhe i sqaron informacionet e paqarta që i kanë paraqitur nxënësit.

### Aktivitete shtesë:

Mësimdhënësi/ja udhëzon secilin grup për përgatitjen e një projekti me temën “Italia sot”. Katër grupe përgatitin tema të ndryshme, p.sh.: grupei parë: *Popullsia e Italisë*; grupei i dytë: *Arsimi në Itali*; grupei i tretë: *Zhvillimet ekonomike në Itali*; grupei i katërt: *Roli i Italisë në pavarësinë dhe zhvillimin e Kosovës*.

### Vlerësimi:

Vlerësimi i nxënësve për bashkëpunim në grup;  
 Vlerësimi i nxënësve për punë individuale;  
 Vlerësimi i nxënësve për përgatitje të projekteve;  
 Vlerësimi i nxënësve për performancën në prezantime.

## 36. AUSTRO-HUNGARIA

|  |                          |   |                    |
|--|--------------------------|---|--------------------|
| Fusha kurrikulare:<br><b>Shoqëria dhe Mjedis</b> | Lënda:<br><b>Histori</b> | Shkalla e kurrikulës:<br><b>Shkalla 4</b> | Klasa:<br><b>8</b> |
|--|--------------------------|---|--------------------|

**RNF:**2.1. Krahason ngjarjet shoqërore, historike, politike, ekonomike e kulturore, si dhe dukuritë (fenomenet) natyrore e mjedisore, shpjegon shkaqet dhe pasojat e tyre, si edhe ndikimin që kanë ato në jetën e njerëzve.

4.1. Arsyeton llojet e vendimmarres në jetën e përditshme shoqërore, e kuption nevojën dhe rëndësinë e zbatimit të procedurave demokratike përgjatë proceseve.

**RNSH:**Kompetenca  
I – 5, 6. II – 5. II – 8.

### Rezultatet e të nxënëtit të lëndës::

**Nxënësi/ja:** identifikon karakteristikat kryesore të revolucioneve të vitit 1848 në Evropë.

Identifikon lëvizjet për krijimin e shteteve kombëtare në Evropë.

Dallon sistemet e ndryshme shtetërore e qeverisësë të periudhës moderne dhe i krahason mënyrat e vendimmarres institucionale (absolutizmi dhe parlamentarizmi).

Vlerëson evoluimin e të drejtave qytetare dhe ndryshimin e rolit të qytetarëve në vendimarrje.

**Kriteri i suksesit:** kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë;

**Fjalë kyçe:** Austria, popujt e robëruar, Monarkia Dualiste, Vjena, habsurgët, zhvillimi ekonomik, politika e jashtme;

**Burimet:** libri, fotografitë, hulumtimet në internet;

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:** teknologji, sociologji.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

### Pjesa hyrëse:

Këtë fazë të orës mësimore fillojmë me teknikën *Brainstorming* (*Stuhim mendimesh*), duke parashtruar pyetje rreth njësisë që do të zhvillohet. P.sh.: cilat kombe ishin nën kontrollin e Vjenës? Cilat shtete me forcën e armëve kërkuan autonominë e plotë të vendit të tyre? Po te ne a mund të na tregoni se si u fitua pavarësia? Kush ishin kontribuuesit më të mëdhenj në këtë proces? Cila qeveri austro-hungareze ishte më jetëgjata, e cila propozoi një varg reformash? etj.

### Pjesa kryesore:

Në këtë fazë të orës mund të përdoret teknika *Fleta e eksperdit*. Mësimdhënësi/ja fillimisht e ndan klasën në tri grupe të mëdha. Më pastaj, vazhdon me ndarjen e njësisë mësimore në tri pjesë. Nxënësit i ndan në grupe familjare, të cilat i cakton me numra nga 1 deri në 3, pavarësisht se disa

nxënës mund ta kenë numrin e njëjtë. Të gjithë nxënësit e caktuar me numrin një bashkohen në një grup të përbashkët, dyshet në grup tjetër e kështu me radhë, të cilët në bazë të udhëzimeve e mësojnë në grup tërë njësinë mësimore, për t'i gjetur përgjigjet e pyetjeve të parashtruara nga mësimdhënësi. Pyetjet duhet të janë të përfshira nga e tërë njësia mësimore, në mënyrë që nxënësit të lexojnë jo vetëm një pjesë, por komplet njësinë. P.sh.: për grupin e parë pyetjet mund të janë: Grupi i parë: cilat ishin prirjet nacionaliste në Austri?


Grupi i dytë: analizoni kushtet dhe rrethanat në të cilat u formua Mbretëria Austro-Hungareze.

Grupi i tretë: vlerësoni orientimet kryesore të politikës së jashtme të Vjenës.

Të gjithë këta nxënës të caktuar në grupet e tyre, në bashkëpunim e mësojnë njësinë sa më mirë, pastaj kthehen në grupet familjare dhe reflektojnë te grupet e tyre për atë çfarë kanë mësuar. Duke u nisur nga pjesa e parë, vetë nxënësit do t'u shpjegojnë nxënësve të tjera pjesët e mësuara. Nxënësit e tjera kanë të drejtë të bëjnë pyetje gjersa ta mësojnë mësimin mirë.

#### Pjesa përfundimtare:

Në fazën përfundimtare të orës nxënësit në punë individuale do të reflektojnë përmes teknikës *Diagrami i Venit* për ngjashmëritë dhe të veçantat e Mbretërisë së Babilonisë dhe Persisë. Më pas, do të bashkëpunojnë në grup, duke bërë një përbledhje të ideve individuale në atë grupore. Idetë e përbledhura të nxënësve do të shkruhen në tabelë nga ana e mësimdhënësit përmes teknikës *Diagrami i Venit*.



#### Aktivitete shtesë:

Mësimdhënësi/ja udhëzon se cilin grup që të përgatitë në PowerPoint njësinë mësimore "Austro-Hungaria". Katër grupe përgatitin tema të ndryshme, p.sh.: grupi i parë: *Ngjarjet e vitit 1848*; grupi i dytë: *Kriza e Perandorisë austriake*; grupi i tretë: *Zhvillimet ekonomike*; grupi i katërt: *Politika e jashtme e Austro-Hungarisë*.

#### Vlerësimi:

Nxënësit vlerësohen për punë individuale;

Për bashkëpunim dhe angazhim në grup;

Nxënësit vlerësohen për përdorimin e TIK-ut për hulumtime.

## 37. RUSIA

|   |                          |   |                    |
|---|--------------------------|---|--------------------|
| Fusha kurrikulare:<br><b>Shqëria dhe Mjedis</b> | Lënda:<br><b>Histori</b> | Shkalla e kurrikulës:<br><b>Shkalla 4</b> | Klasa:<br><b>8</b> |
|---|--------------------------|---|--------------------|

**RNF:** 2.1. Krahason ngjarjet shoqërore, historike, politike, ekonomike e kulturore, si dhe dukuritë (fenomenet) natyrore e mjedisore, shpjegon shkaqet dhe pasojat e tyre, si edhe ndikimin që kanë ato në jetën e njerëzve.

4.2. Krahason llojet e ndryshme të vendimmarjeve dikur dhe tani, si dhe reagon dhe shpreh qëndrimet e tij ndaj dukurive negative në bashkësinë ku vepron dhe në shoqëri.

**RNSH:** Kompetenca  
I - 6. II – 4, 7

### Rezultatet e të nxënëtit të lëndës::

**Nxënësi/ja:** dallon karakteristikat kryesore të absolutizmit në Evropë dhe krahason veçoritë e tij në vendet e ndryshme.

Dallon sistemet e ndryshme shtetërore e qeverisëse të periudhës moderne dhe krahason mënyrat e vendimmarjes institucionale (absolutizmi dhe parlamentarizmi).

**Kriteri i suksesit:** kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë;

**Fjalë kyçe:** Rusia, cari, fshatarësi, Aleksandri II, Aleksandri III, koncepti liberal, marksistët, Partia Socialdemokrate;

**Burimet:** libri, fotografitë, harta gjeografike, harta historike;

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:** sociologji.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

### Pjesa hyrëse:

Në këtë fazë të orës mësimdhënësi i nxit nxënësit që të mendojnë lirshëm se çfarë dinë për temën *Rusia*. Nxënësit në mes të fletës e shkruajnë fjalën *Rusia*, duke krijuar një degëzim rreth asaj se ç‘dinë për këtë shtet (*Kllasteri ose Pema e mendimit*). Ky aktivitet zhvillohet në dyshe. Mësimdhënësi/ja idetë e nxënësve i shkruan në tabelë dhe bën një degëzim sipas rendit logjik.

### Pjesa kryesore:

Në këtë fazë të orës, mësimdhënësi/ja i udhëzon nxënësit që ta lexojnë njësinë mësimore. Njësia mësimore është e ndarë në tre nëntituj: *Rusia në gjysmën e dytë të shekullit XIX; Organizimi politik; Rusia në fillim të shekullit XX*. Leximi bëhet në mënyrë individuale. Nxënësit e lexojnë

vetëm pjesën e parë dhe e mbyllin tekstin. Pas leximit të pjesës së parë, nxënësve u parashtron pyetje. P.sh.: cilën luftë e humbi Rusia kundër Francës në aleancë me Anglinë? Si e trajtonte fshatarësinë fisnikëria? etj. Pas përfundimit të pjesës së parë, nxënësit vazhdojnë ta lexojnë pjesën e dytë të njësisë mësimore *Organizimi politik*. Pasi ta përfundojnë leximin, mësimdhënësi/ja parashtron pyetje për organizimin politik të Rusisë, p.sh.: për çfarë njihet në histori Perandori Aleksandri II? Çfarë shteti ishte Perandoria Ruse dhe në duart e kujt ishte i koncentruar Car-Perandori?

Pastaj, vazhdojnë ta lexojnë pjesën e tretë të njësisë mësimore *Rusia në fillim të shekullit XX*. Pyetjet mund të jenë p.sh.: në çka u fokusua Nikolla II në vitin 1894? Çka i shkaktoi pakënaqësitë e mëdha popullore? etj. Përveç mësimdhënësit/es që parashtron pyetje, edhe nxënësit duhet të nxiten t'i parashtron pjesën e dytë të njësisë mësimore *Rusia në fillim të shekullit XX*.

### **Pjesa përfundimtare:**

Për reflektim mësimdhënësi/ja i udhëzon nxënësit që të shkruajnë një pesëvargësh. Nxënësit e shkruajnë në mënyrë individuale pesëvargëshin. Pesëvargëshi shkruhet për Rusinë. Ecuria e zbatimit të kësaj teknike është kjo: të shkruhet emri i temës në fletore apo në dërrasë të zezë. Në vargun e dytë shkruhen dy mbiemra, në vargun e tretë tri folje, në vargun e katërt një fjali dhe në vargun e pestë sinonimi.

### **Aktivitete shtesë:**

Diskutim: A do të isha ndryshe, sikur të rriteshë një kulturë tjeter?

### **Vlerësimi:**

Vlerësim formativ;  
Vlerësim në komunikim;  
Vlerësim në bashkëpunim në grup dhe individual.

**XII. SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS NË FUND TË SHEKULLIT XIX NË  
FILLIM TË SHEKULLIT XX**  
**38. LUFTA CIVILE NË SHBA**

|   |                          |   |                    |
|---|--------------------------|---|--------------------|
| Fusha kurrikulare:<br><b>Shqëria dhe Mjedis</b> | Lënda:<br><b>Histori</b> | Shkalla e kurrikulës:<br><b>Shkalla 4</b> | Klasa:<br><b>8</b> |
|---|--------------------------|---|--------------------|

**RNF:**1.2. Dallon faktet nga opinionet, figurat reale nga ato mitike e legjendare, gjatë interpretimit të situatave të ndryshme në marrëdhëniet midis individëve apo të grupeve shoqërore (në kohë dhe hapësirë).

2.2. Shpjegon përbërjen e gjeosferës, si dhe analizon rolin e resurseve natyrore në mjedisin dhe në zhvillimin ekonomik të një vendi, rajoni, shteti apo kontinenti.

**RNSH:**Kompetenca  
II – 2, 5, 8.

**Rezultatet e të nxënëtit të lëndës:**

**Nxënësi/ja:** dallon personalitetet e rëndësishme botërore të periudhës moderne dhe vlerëson rolin dhe kontributin e tyre.

Identifikon veçoritë socio-ekonomike midis shteteve veriore dhe jugore, si dhe shpjegon shkaqet dhe ecurinë e Luftës Civile në ShBA.

**Kriteri i suksesit:** kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë;

**Fjalë kyçe:** ShBA, ekonomia, Lufta Civile, Abraham Linkoln, gjenerali Grant, Robert Li, konfederata, zgjedhjet;

**Burimet:** libri, fotografitë, harta gjeografike, harta historike;

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:** teknologji, ekonomi.

**METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË**

**Pjesa hyrëse:**

Këtë fazë të orës mësimore mësimdhënësi/ja e realizon duke diskutuar përmes pyetjeve dhe përgjigjeve me nxënës. Pyetjet që i parashtron nxënësve mund të jenë pyetje të hapura, të cilat e zhvillojnë mendimin kritik të nxënësve, duke ua mundësuar shprehjen e lirë të tyre.

**Pjesa kryesore:**

Formohen grupe nxënësish me po aq anëtarë sa edhe ka pjesë të njësisë mësimore. Njësia mësimore ka tri pjesë, siç janë: *Zgjerimi i ShBA-së; Lufta Civile në ShBA; Zhvillimi ekonomik dhe politika e jashtme deri në vitin 1914*. Mësimdhënësi/ja e ndan klasën në tri grupe dhe i udhëzon se si të punohet. 1) Leximi bëhet me ndalesa pas secilës pjesë. 2) Të gjithë anëtarët e grupit e lexojnë pjesën e parë. 3) Një anëtar i grupit e luan rolin e mësuesit. 4) Puna e tij ka tri role:

a) e shpjegon kuptimin e pjesës së lexuar; b) jep përgjigje, sqarime në pyetjet e anëtarëve të grupit; c) dhe bën pyetje për anëtarët e tjerë të grupit. Ecuria është e njëjtë për të gjitha pjesët e mësimit, vetëm që nxënësit ndërrohen. Për secilën pjesë të mësimit bartet përgjegjësia e mësuesit te nxënësi tjeter.

### **Pjesa përfundimtare:**

Për t'i nxitur nxënësit që të diskutojnë për përbajtjet mësimore që i mësuan gjatë realizimit të kuptimit, mësimdhënësi/ja në dërrasën e zezë formon një skemë, duke u bazuar në ulëset e nxënësve. Bëhet një pyetje nga mësimdhënësi/ja dhe ftohen nxënësit që për dy minuta të shkruajnë përgjigje individuale. Pas dy minutash ftohen nxënësit që t'i japin idetë e tyre. Nëse ka përgjigje të kundërtë nga dy nxënës, atëherë ftohet një nxënës i tretë ta japë mendimin e tij se me cilën përgjigje pajtohet dhe përsë pajtohet. Nga nxënësi kërkohet ta argumentojë përgjigjen. Mësimdhënësi/ja nuk jep vetë përgjigje dhe nuk përkrah një mendim kundrejt tjetrit. Me këtë ecuri vazhdohet edhe me pyetje të tjera.

### **Aktivitete shtesë:**

Mësimdhënësi/ja udhëzon secilin grup për ta përgatitur përmes TIK-ut apo me PowerPoint njësinë mësimore *Shtetet e Bashkuara të Amerikës në fund të shekullit XIX në fillim të shekullit XX*. Katër grupe përgatitin tema të ndryshme, p.sh.: grupi i parë: *Abraham Linkolni*; grupi i dytë: *Zgjerimi i ShBA-së*; grupi i tretë: *Luftha civile në ShBA*, grupi i katërt: *Zhvillimi ekonomik dhe politika e jashtme deri në vitin 1914*.

### **Vlerësimi:**

Nxënësit vlerësohen për punë individuale;  
Për bashkëpunim dhe angazhim në grup;  
Nxënësit vlerësohen për përdorimin e TIK-ut për hulumtime (projekte).

## 39. LËVIZJA KUNDËR SKLLAVËRISË-ABOLICIONIZMI

|   |                          |   |                    |
|---|--------------------------|---|--------------------|
| Fusha kurrikulare:<br><b>Shqëria dhe Mjedis</b> | Lënda:<br><b>Histori</b> | Shkalla e kurrikulës:<br><b>Shkalla 4</b> | Klasa:<br><b>8</b> |
|---|--------------------------|---|--------------------|

**RNF:2.1.** Krahason ngjarjet shoqërore, historike, politike, ekonomike e kulturore, si dhe dukuritë (fenomenet) natyrore e mjedisore, shpjegon shkaqet dhe pasojat e tyre dhe ndikimin që kanë ato në jetën e njerëzve.

2.2. Shpjegon përbërjen e gjeosferës, si dhe analizon rolin e resurseve natyrore në mjedisin dhe në zhvillimin ekonomik të një vendi, rajoni, shteti apo kontinenti.

**RNSH:**Kompetenca  
I – 1, 2, 6. II - 8

### Rezultatet e të nxënëtit të lëndës:

**Nxënësi/ja:** vlerëson abolicionizmin dhe format tjera të lirive të njeriut dhe analizon efektet e tyre në avancimin e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Analizon rrethanat që sollën deri te Proklamata e Emancipimit dhe vlerëson ndikimin e saj në emancipimin e shoqërisë amerikane.

**Kriteri i suksesit:** kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë;

**Fjalë kyçë:** abolicionizmi, heqja e skllavërisë, Franca, Anglia, ShBA;

**Burimet:** libri;

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:** sociologji, jurispodencë.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

### Pjesa hyrëse:

Mësimdhënësi/ja e fillon bashkëbisedimin me nxënës në formë të pyetjeve dhe përgjigjeve me nxënës. Përveç mësimdhënësit/es, edhe nxënësit/et po ashtu kanë të drejtë të inkadrohen në parashtrimin e pyetjeve njëri-tjetrit. Mësimdhënësi/ja parashtron pyetjet: A keni dëgjuar për fjalën abolicionizmi apo lëvizja abolicioniste? Cili ishte roli i kishës katolike në fund të shekullit XII? Cili shtet ishte i njohur për numrin e madh të skllevërve? etj. Nxënësit diskutojnë në mënyrë interaktive, duke u lejuar të përgjigjen lirshëm dhe pa iu mohuar e drejta e shprehjes së lirë.

### Pjesa kryesore:

Gjatë kësaj faze të orës nxënësit udhëzohen të lexojnë në mënyrë individuale. Më pastaj, kanë për detyrë të përzgjedhin një pjesë të njësisë mësimore, të marrin shënimë, të formulojnë pyetje për shokun, të komentojnë në dyshe e më pastaj në grup. Pasi të përfundojnë mund të ketë edhe diskutime. Përparësia e kësaj teknike (*Mendo, puno në çifte, thuaja grupit* është se përfshihen të gjithë nxënësit në diskutime).

**Pjesa përfundimtare:**

Pasi të kenë përfunduar, mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit që përmbajtjen e kësaj njësie ta paraqesin përmes vizatimit. Pasi të kenë vizatuar, vizatimet e tyre mund të bëhen në formë të posterit dhe të vihen në mure të klasës.

**Aktivitete shtesë:**

Nxënësit në mënyrë individuale udhëzohen që përmes internetit të hulumtojnë literaturë për personalitetin e ndonjë kryetari të Shteteve të Bashkuar të Amerikës, për të prezantuar sa më mirë para nxënësve të klasës. Prezantimi bëhet përmes projektorit në PowerPoint apo në TV. Gjatë prezantimeve, nxënësit angazhohen për pyetje dhe përgjigje. Komentet e nxënësve të klasës dhe mësimdhënëses/it janë të mirëseardhura.

**Vlerësimi:**

Nxënësit/et vlerësohen për punën individuale;

Nxënësit/et vlerësohen për angazhimin e tyre në integrim të lëndëve;

Nxënësit/et vlerësohen për cilësinë e prezantimit dhe përdorimin e TIK-ut për nevoja mësimore.

### XIII. PERANDORIA OSMANE DHE BALLKANI GJATË SHEK. XIX-FILLIMI I SHEKULLIT XX

#### 40. PERANDORIA OSMANE

|  |                          |   |                    |
|--|--------------------------|---|--------------------|
| Fusha kurrikulare:<br><b>Shoqëria dhe Mjedis</b> | Lënda:<br><b>Histori</b> | Shkalla e kurrikulës:<br><b>Shkalla 4</b> | Klasa:<br><b>8</b> |
|--|--------------------------|---|--------------------|

**RNF:** 2.1. Krahason ngjarjet shoqërore, historike, politike, ekonomike e kulturore, si dhe dukuritë (fenomenet) natyrore e mjedisore, shpjegon shkaqet dhe pasojat e tyre, si edhe ndikimin që kanë ato në jetën e njerëzve.

2.2. Shpjegon përbërjen e gjeosferës, si dhe analizon rolin e resurseve natyrore në mjedisin dhe në zhvillimin ekonomik të një vendi, rajoni, shteti apo kontinenti.

**RNSH:** Kompetenca  
I – 2, 6. II – 1, 5.

#### Rezultatet e të nxënësit të lëndës:

**Nxënësi/ja:** dallon karakteristikat kryesore të absolutizmit në Evropë dhe krahason veçoritë e tij në vendet e ndryshme.

Dallon tiparet kryesore të organizimi administrativ-shtetëror dhe shoqëror të Perandorisë Osmane dhe Habsburge dhe i krahason ato.

Përkruan pozitën e popujve të Ballkanit në kuadër të Perandorisë Osmane dhe Austro-Hungareze dhe analizon marrëdhënet e tyre me pushtetin qendror.

**Kriteri i suksesit:** kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë; **Fjalë kyçe:** perandoria, qeveria, osmane, sulltani, reformat, tanzimati, osmanët e rinj, përplasjet politike, parlamenti osman;

**Burimet:** libri, fotografitë;

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:** ed. qytetare, sociologji.

### METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

#### Pjesa hyrëse:

Mësimdhënësi/ja në këtë fazë të orës e përdor teknikën *Parashikim me terma paraprakë*. Mësimdhënësi e ndan tabelën në dy kolona. Në secilën kolonë shkruan nga disa terma: *kolona 1*- perandoria, qeveria, osmane, sulltani, reformat; *kolona 2*: tanzimati, osmanët e rinj, përplasjet politike, parlamenti osman. Në vazhdim mësimdhënësi/ja klasën e ndan në dy grupe të mëdha dhe i udhëzon që nga termet e kolonave të tyre të krijojnë një histori të shkurtër. Pasi të shkruajnë, nxënësit vullnetarisht lexojnë.

### **Pjesa kryesore:**

Në këtë fazë të zhvillimit të orës mësimore, nxënësit udhëzohen që gjatë leximit të tekstit të përcaktohen për një apo më shumë pjesë që për ta janë më interesante dhe më të rëndësishme. Pjesa e përzgjedhur dhe numri i faqes shënohen në një fletëz, ndërsa në anën tjetër të fletës shkruhet një koment për pjesën e përzgjedhur të njësisë. P.sh.: pse e kanë përzgjedhur njësinë që flitet për periudhën e Tanzimatit apo për përpjekjet e qeverisë osmane për reforma? Njëri nga nxënësit e tregon faqen se ku e ka zgjedhur pjesën, e lexon atë, ndërsa të tjerët e përcjellin në libër gjatë leximit. Pas leximit, të tjerët diskutojnë rrëth citatit. Në fund të diskutimit, nxënësi i cili është përcaktuar për pjesën, e lexon komentin e tij për atë citat. Pas leximit të këtij komenti, nxënësit e tjerë nuk kanë të drejtë të japid komente shtesë. E njëjta ecuri e leximit të citatit dhe komentimit praktikohet edhe te nxënës të tjerë.

### **Pjesa përfundimtare:**

Nxënësit së pari në ndahan në dyshe, pastaj në grup diskutojnë për pjesën që e kanë lexuar, pastaj diskutojnë për informacione të reja dhe më në fund nxjerrin përfundime. Mësimdhënësi/ja angazhon një anëtar të grupeve përfundimet e nxjerra gjatë bashkëbisedimit. Anëtarët i grupeve mund të përzgjidhet edhe në këtë formë: nxënësit i vënë lapsat mbi bankë. Mësimdhënësi/ja e bën përzgjedhjen e një lapsi dhe grupeve atëherë e përfaqëson ai nxënës, lapsin e të cilët e përzgjedh mësimdhënësi/ja.

### **Aktivitete shtesë:**

Nxënësit e lexojnë në mënyrë individuale njësinë mësimore. Pasi ta lexojnë, secili grup e bën përzgjedhjen e një nxënësi i cili ka përdetyrë që të bëjë intervista në grup në raport me njësinë.

### **Vlerësimi:**

Nxënësit vlerësohen për angazhim individual dhe grupor;

Nxënësit vlerësohen për gatishmëri dhe bashkëpunim në grup;

Nxënësit vlerësohen në komunikim.

#### XIV. SHQIPTARËT NË SHEKULLIN XIX

##### 41. SHQIPTARËT NË PERIUDHËN E TANZIMATIT DHE FILLET ERILINDJES KOMBËTARE SHQIPTARE

Fusha kurrikulare:

**Shqëria dhe Mjedis**

Lënda:

**Histori**

Shkalla e kurrikulës:

**Shkalla 4**

Klasa:

**8**

**RNF:** 2.1. Krahason ngjarjet shoqërore, historike, politike, ekonomike e kulturore, si dhe dukuritë (fenomenet) natyrore e mjedisore, shpjegon shkaqet dhe pasojat e tyre, si edhe ndikimin që kanë ato në jetën e njerëzve.

4.1. Arsyeton llojet e vendimmarjes në jetën e përditshme shoqërore, kupton nevojën dhe rëndësinë e zbatimit të procedurave demokratike përgjatë proceseve.

**RNSH:** Kompetenca

I – 2, 6. II – 5, 8.

##### Rezultatet e të nxënësit të lëndës:

**Nxënësi/ja:** përshkruan fillet e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare dhe i identifikon personalitetet më të shquara shqiptare të Rilindjes dhe rolin e tyre.

Dallon sistemet e ndryshme shtetërore e qeverisëse të periudhës moderne dhe krahason mënyrat e vendimmarjes institucionale (absolutizmi dhe parlamentarizmi).

**Kriteri i suksesit:** kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë;

**Fjalë kyçe:** Tanzimat, shqiptarët, kryengritje, pasoja, rilindësit, Naum Veqilharxhi, Evetari, kërkesat politike;

**Burimet:** libri, interneti;

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:** letërsi, sociologji.

#### METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

##### Pjesa hyrëse:

Kjo fazë e orës mësimore mund të zhvillohet në këtë mënyrë: Nxënësve u jepet një temë apo u shtrohet një pyetje që ata janë të lirë të shkruajnë rrëth saj. Në këtë rast nxënësit udhëzohen që të shkruajnë një shkrim të lirë për “Fillet e Rilindjes në Shqipëri”. Nxënësit shkruajnë lirshëm rrëth kësaj teme. Më pastaj lexohet nga një shkrim prej secilit grup.

##### Pjesa kryesore:

Nxënësit ndahen në katër grupe me nga katër anëtarë. Ata brenda grupeve numërohen: 1,2,3,4 në mënyrë që secili grup të ketë nga katër anëtarë, prej 1 deri në 4. Meqë numri i nxënësve është më i madh, mund të dyfishohen numrat e përcaktuar. Kjo vetëm ndihmon që grupi i ekspertëve të

ta zoterojnë më mirë pjesëzën e tyre. Nxënësit njoftohen për mësimin që do ta mësojnë. Nxënësit njoftohen se njësia mësimore është e ndarë në katër pjesë:

- 1.) *Pasojat e Tanzimatit në Shqipëri;*
- 2.) *Kryengritjet shqiptare kundër Tanzimatit;*
- 3.) *Ngritja e vetëdijes Kombëtare dhe fillet e Rilindjes në Shqipëri;*
- 4.) *Rilindësit e parë.*

Nxënësit që kanë numrin 1 janë përgjegjës që të mësojnë për *Pasojat e Tanzimatit në Shqipëri*. Nxënësit që kanë numrin 2 janë përgjegjës që të mësojnë për *Kryengritjet shqiptare kundër Tanzimatit*. Nxënësit me numrin 3 janë përgjegjës që të mësojnë për *Ngritjen e vetëdijes kombëtare dhe fillet e Rilindjes në Shqipëri*. Ndërsa nxënësit me numrin 4 janë përgjegjës për temën *Rilindësit e parë*. Qëllimi përfundimtar është që secili nxënës t'i mësojë katër pjesët e njësisë mësimore. Pas leximit të pjesës së njësisë, nxënësit që kanë numrin 1 ulen së bashku; nxënësit me numër 2 po ashtu ulen bashkë e kështu me radhë deri në numrin katër. Nxënësit njoftohen se grupet e formuara tanë quhen grupe ekspertësh, ndërsa grupet fillestare quhen grupe familjare apo të bashkëpunimit. Grupet e ekspertëve duhet të dinë se pas mësimit të pjesës do të kthehen në grupe familjare dhe atje do t'ua shpjegojnë anëtarëve të tjera të grupit pjesën që e kanë mësuar. Gjatë shpjegimit ata duhet të sigurohen se të gjithë anëtarët e grupit e kanë kuptuar njësinë në tërësi. Kjo teknikë pune krijon vetëbesim, përgjegjësi individuale dhe kolektive te nxënësit.

### **Pjesa përfundimtare:**

Përmes teknikës *Rishikim me rigrupim*, mësimdhënësi/ja mund ta realizojë reflektimin e orës mësimore. Mësimdhënësi/ja secilit grup ia jep nga një fletë, në të cilën është e shkruar ndonjëra prej këtyre temave që i kanë mësuar në realizim të kuptimit. Secili nxënës i grupit, pasi ta përfundojnë punën në fletë, fletat vazhdojnë t'i përcjellin nga një grup te tjetri, derisa të gjitha grupet t'i shkruajnë mendimet e tyre për temën apo t'i plotësojnë mendimet që i kanë dhënë grupet e tjera.

### **Aktivitete shtesë:**

Mësimdhënësi/ja, nxënësit i ndan në katër grupe. Nxënësit në grupe përcaktohen për të përgatitur një temë përmes hulumtimit në internet: temat përzgjidhen nga mësimdhënësi/ja. Temat janë: *Naum Veqilharxhi, Hasan Tahsini, Jeronim De Rada, Elena Gjika*. Nxënësit i prezantojnë punimet para gjithë klasës. Nxënësit janë të lirë të komentojnë për prezantimin e jo për nxënësin.

### **Vlerësimi:**

Nxënësit vlerësohen në punën hulumtuese;  
Nxënësit vlerësohen për përdorimin e TIK-ut për nevoja mësimore;  
Nxënësit vlerësohen për performancën në prezantim.

## 42. FORMIMI I LIDHJES SHQIPTARE TË PRIZRENIT

|   |                          |   |                    |
|---|--------------------------|---|--------------------|
| Fusha kurrikulare:<br><b>Shqëria dhe Mjedis</b> | Lënda:<br><b>Histori</b> | Shkalla e kurrikulës:<br><b>Shkalla 4</b> | Klasa:<br><b>8</b> |
|---|--------------------------|---|--------------------|

**RNF:** 2.1. Krahason ngjarjet shoqërore, historike, politike, ekonomike e kulturore, si dhe dukuritë (fenomenet) natyrore e mjedisore, shpjegon shkaqet dhe pasojat e tyre, si dhe ndikimin që kanë ato në jetën e njerëzve.

2.2. Shpjegon përbërjen e gjeosferës, si dhe analizon rolin e resurseve natyrore në mjedisin dhe në zhvillimin ekonomik të një vendi, rajoni, shteti apo kontinenti.

**RNSH:** Kompetenca  
I – 2, 5. II – 3, 8.

### Rezultatet e të nxënëtit të lëndës::

**Nxënësi/ja:** pëershruan fillet e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare dhe identifikon personalitetet më të shquara shqiptare të Rilindjes dhe rolin e tyre.

Analizon rrethanat që ndikuan në krijimin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe vlerëson veprimtarinë dhe programin e Lëvizjes Kombëtare.

Identifikon dhe shqyrton organizimet dhe veprimet politike e ushtarake që pasuan Lidhjen Shqiptare të Prizrenit deri në Shpalljen e Pavarësisë.

**Kriteri i suksesit:** kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë;

**Fjalë kyçë:** Kriza Lindore, Lufta Ruso-Turke, Traktati, Bullgaria, Serbia, Mali i Zi, shpërngulja, Lidhja Shqiptare e Prizrenit;

**Burimet:** libri, fotografi, materiale interneti;

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:** ed. qytetare, sociologji.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

### Pjesa hyrëse:

Këtë fazë të orës mësimore mësimdhënësi/ja diskuton me nxënës për krizën lindore dhe shqiptarët. Diskutimin e zhvillon përmes pyetjeve dhe përgjigjeve. Dhënia e ideve mund të jetë në mënyrë individuale, më pas bashkim i ideve në çifte e në grup. Bëhet një pyetje, që ua mundëson nxënësve të jepin përgjigje të ndryshme. Nxënësit nuk duhen të kufizohen në përgjigje. Pyetjet mund të parashtohen, p.sh.: cilat kryengritje dhe veprime ndikuan në shfaqjen e krizës lindore? Cila ishte arsyaja e themelimit të Lidhjes së Prizrenit? etj.

### Pjesa kryesore:

Të lexuarit në dyshe, apo bashkëpunim. Nxënësve u kërkohet që të zgjedhin nga një partner për çift, ngase e gjithë puna do të bëhet në bashkëpunim të çifteve. Duke i numëruar çiftet (1,2,3,4,5,

secilit çift në klasë i caktohet numri nga 1 deri 5. Kjo bëhet ngase mësimi është i ndarë në 5 pjesë dhe secili çift duhet ta mësojë pjesën me numrin përkatës. Çiftet informohen se leximi do të jetë i veçantë dhe u jepen këto udhëzime: dy anëtarët e çiftit do të lexojnë në mënyrë individuale të gjithë tekstin që u është dhënë. Pastaj, çiftet e ndajnë atë tekst në dy pjesë. Pas leximit, pjesën e parë të tekstit e ka për detyrë ta shpjegojë nxënësi A i çiftit, ndërsa anëtarëti B i bën pyetje A-së për të njëjtën pjesë. Në pjesën e dytë të tekstit, ndërrohen rolet. Nxënësi B është raportues dhe përgjigjedhënës, ndërsa nxënësi A është pyetësi. Nxënësit duhet të sigurohen se e kanë mësuar mirë njësinë sepse më vonë në grupe do të jenë raportues dhe përgjigjedhënës. Më pastaj, çiftet paraqesin përmbledhjen e pjesës së tyre në fletë transparente, duke filluar nga pjesa e parë e artikullit, nga një çift nga secila pjesë, do të dalë dhe do ta paraqesë përmbledhjen e pjesës së vet para gjithë klasës.

### **Pjesa përfundimtare:**

Nxënësve u caktohet një temë për të cilën do të shkruajnë, p.sh., tema *Rëndësia e Lidhjes së Prizrenit*. Nxënësit shkruajnë në mënyrë individuale, pastaj shkëmbejnë idetë dhe formojnë një shkrim të përbashkët. Më në fund shkrimi lexohet nga përfaqësuesit e grupit.

### **Aktivitete shtesë:**

Mësimdhënësi/ja i udhëzon nxënësit që të përzgjedhin se çfarë aktiviteti do të marrin për përforcimin e kësaj njësie mësimore:

1. Vizatim të portretit të Abdyl Frashërit;
2. Përgatitja e një dokumentari të shkurtër për Lidhjen e Prizrenit.

### **Vlerësimi:**

Nxënësit vlerësohen për punën individuale;

Nxënësit vlerësohen për bashkëpunim në grup;

Nxënësit vlerësohen për punë hulumtuese dhe krijuese;

Nxënësit vlerësohen në performancën e prezantimeve.

## 43. KONGRESI I BERLINIT DHE SHQIPTARËT

|   |                          |   |                    |
|---|--------------------------|---|--------------------|
| Fusha kurrikulare:<br><b>Shqëria dhe Mjedis</b> | Lënda:<br><b>Histori</b> | Shkalla e kurrikulës:<br><b>Shkalla 4</b> | Klasa:<br><b>8</b> |
|---|--------------------------|---|--------------------|

**RNF:** 2.1. Krahason ngjarjet shoqërore, historike, politike, ekonomike e kulturore, si dhe dukuritë (fenomenet) natyrore e mjedisore, shpjegon shkaqet dhe pasojat e tyre, si dhe ndikimin që kanë ato në jetën e njerëzve.

4.1. Arsyeton llojet e vendimarrjes në jetën e përditshme shoqërore, kupton nevojën dhe rëndësinë e zbatimit të procedurave demokratike përgjatë proceseve.

**RNSH:** Kompetenca  
I – 2, 6. II – 5, 8.

### Rezultatet e të nxënësit të lëndës:

**Nxënësi/ja:** debaton për rrëthanat e krijimit të shteteve kombëtare në Ballkan.

Dallon sistemet e ndryshme shtetërore e qeverisëse të periudhës moderne dhe i krahason mënyrat e vendimarrjes institucionale (absolutizmi dhe parlamentarizmi).

**Kriteri i suksesit:** kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë;

**Fjalë kyçe:** kongresi, Fuqitë e Mëdha, shqiptarët, serbët, malazezët, grekët, vendimet, copëtimi, mbrojtja;

**Burimet:** libri, fotografitë, harta gjeografike, harta historike;

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:** gjeografi, sociologji, ed. qytetare.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

### Pjesa hyrëse:

Në këtë fazë të evokimit mund të përdoret teknika *Parashikim nëpërmjet fjalëve kyce*. Kjo teknikë është e përshtatshme për lidhjen emocionale të nxënësit me njësinë e re mësimore. Ecuria është: Caktohen katër terma që përdoren shpesh brenda mësimit, fjalë kyçe të mësimit, si: kongresi, fuqitë e mëdha, shqiptarët, serbët, copëtimi, vendimi. Me këto fjalë kyçe nxënësit thurin një ngjarje. Më pas, nxënësit në dyshe shkëmbejnë ngjarjet e thurura apo lexohen disa nga këto krijime të nxënësve para gjithë klasës.

### Pjesa kryesore:

Në këtë fazë të mësimit, mësuesi/ja u tregon nxënësve se çka do të lexojnë dhe gjatë leximit ata do të marrin shënimë. Më pas u tregohet që fleta të ndahet në mes me një vijë vertikale. Më pastaj

gjatë leximit në të majtë të faqes shkruajnë ndonjë mesazh apo citat nga teksti (pjesa që u bën përshtypje), ndërsa në anën e djathtë duhet të shkruhen komentet: pse jeni përcaktuar për atë citat? Çfarë ju bëri përshtypje? Çfarë pyetjesh keni? (komenti përse ju bëri përshtypje). Të njëjtin lexim e bën edhe mësimdhënësi/ja. Në fund të leximit kërkohen vullnetarë (2-3 veta) që t'i japin komentet e tyre. Pas leximit të pjesës që u ka bërë përshtypje, vullnetarëve u shtrohen këto pyetje: pse u tërhoqi vëmendjen kjo pjesë? Çka u bëri të mendoni? Po ashtu, shtrohen pyetjet: a ka ndonjë tjetër që e ka zgjedhur të njëjtën pjesë. A ka ndonjë arsyet tjetër që e ka zgjedhur atë pjesë? Në fund mësimdhënësi/ja jep komentet e saj/tij të nxjerra gjatë leximit që ai/ajo ka bërë. Në fund parashtrohen pyetjet: çfarë do të mbani mend nga ky material? Cili është mesazhi më i rëndësishëm?

#### **Pjesa përfundimtare:**

Në këtë fazë mësimdhënësi/ja mund t'u bëjë nxënësve një pyetje. Pyetjes gjithherë duhet t'i shtohet edhe pjesa që kërkon argumentin e çështjes. P.sh.: pse në Kongresin e Berlinit nuk u respektuan të drejtat e popujve për liri e shtet kombëtar? Disa nga përgjigjet lexohen dhe diskutohen.

#### **Aktivitete shtesë:**

Grupet e nxënësve përgatitin nga pesë pyetje për grupet e tjera. Grupet përzgjedhin udhëheqësin e grupit i cili ka për detyrë ta prezentojë grupin.

#### **Vlerësimi:**

Vlerësim në punë krijuese;

Vlerësimi në bashkëpunim dhe angazhim në grup;

Vlerësim në komunikim.

## 44. PËRPJEKJET E LIDHJES PËR FORMIMIN E SHTETIT SHQIPTAR

|   |                          |   |                    |
|---|--------------------------|---|--------------------|
| Fusha kurrikulare:<br><b>Shqëria dhe Mjedis</b> | Lënda:<br><b>Histori</b> | Shkalla e kurrikulës:<br><b>Shkalla 4</b> | Klasa:<br><b>8</b> |
|---|--------------------------|---|--------------------|

**RNF:2.1.** Krahason ngjarjet shoqërore, historike, politike, ekonomike e kulturore, si dhe dukuritë (fenomenet) natyrore e mjedisore, shpjegon shkaqet edhe pasojat e tyre, si dhe ndikimin që kanë ato në jetën e njerëzve.

**RNSH:**Kompetenca  
I – 2, 5. II – 1, 5.

### Rezultatet e të nxënësit të lëndës::

**Nxënësi/ja:** debaton për rrëthanat e krijimit të shteteve kombëtare në Ballkan.

Analizon rrëthanat që ndikuani në krijuimin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe vlerëson veprimtarinë dhe programin e Lëvizjes Kombëtare.

Identifikon dhe shqyrton organizimet dhe veprimet politike e ushtarake që pasuan Lidhjen Shqiptare të Prizrenit deri në Shpalljen e Pavarësisë.

**Kriteri i suksesit:** kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë;

**Fjalë kyçe:** Lidhja, platforma, Porta e Lartë, lufta, autonomia, pavarësia, qeveria e përkohshme, Ilaz pashë Dibra, Abdyl Frashëri, Ymer Prizreni, Mic Sokoli;

**Burimet:** libri, fotografitë, harta gjeografike, harta historike;

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:** ed. qytetare.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

### Pjesa hyrëse:

Mendo, puno në dyshe. Në këtë fazë të orës mësimore mësimdhënësi/ja kërkon nga anëtarët e grupit që të bashkohen në dyshe, dhe më pas të veprohet sipas këtyre hapave: njëri nga anëtarët në çift ka për detyrë të shkruajë një temë, p.sh.: të pëershkruejë një ngjarje kur Kosova ka marrë vendime të mëdha. Ndërsa anëtarë tjetër i çiftit shkruan një ngjarje kur shqiptarët janë dëbuar jashtë vendit të tyre në periudha të ndryshme kohore. Pasi ta kenë përfunduar shkrimin, dyshet i shkëmbejnë përvojat. Në fund brenda secilit grup, një apo dy dyshe diskutojnë për ngjarjet për të cilat kanë shkruar. Diskutimi vazhdon me pyetje të tjera që rrjedhin nga gjendja në klasë.

### Pjesa kryesore:

(Mësimdhënia e ndërsjellë). Në klasë formohen grupe nxënësish me po aq anëtarë, sa ka edhe pjesë të mësimit. Mësimdhënësi/ja jep udhëzime se si të punohet. Leximi bëhet me ndalesa, pas secilës pjesë. Të gjithë anëtarët e grupit fillojnë të lexojnë pjesën e parë. Një anëtar i grupit e luan rolin e mësuesit. Puna e tij ka tri role: 1) shpjegon kuptimin e pjesës së lexuar; 2) jep përgjigje,

sqarime në pyetjet e anëtarëve të grupit; 3) prashtron një pyetje për anëtarët e tjerë të grupit, për pjesën tjeter të leximit, duke e luajtur rolin e mësuesit/es. Procesi vazhdon me leximin e dytë nga të gjithë anëtarët e grupit. Prapë vazhdohet si në pjesën e parë. Puna mund të bëhet në grupe, nëse grupet kanë anëtarë, aq sa ka pjesë mësimi.

### Pjesa përfundimtare:

*Pesëvargëshi.* Mësimdhënësi/ja e shkruan në tabelë (dërrasë të zezë) emrin e temës apo një emër që k“a të bëjë me këtë temë. Meqenëse në këtë njësi kemi të bëjmë me Lidhjen e Prizrenit, atëherë si temë marrim “Lidhja e Prizrenit”. E shkruajmë në tabelë *Lidhja e Prizrenit*, po ashtu edhe nxënësit veprojnë njëjtë. Vazhdojmë: nën të shënojmë dy mbiemra, që nxënësit së pari në mënyrë individuale i shkruajnë, pastaj vazhdojmë me tri folje, një fjali përfundimtare dhe me sinonimin e fjalisë.

1. Lidhja e Prizrenit
2. dy mbiemra \_\_\_\_\_
3. tri folje \_\_\_\_\_
4. një fjali \_\_\_\_\_
5. sinonimi \_\_\_\_\_

### Aktivitete shtesë:

Nxënësit debatojnë për shuarjen e Lidhjes së Prizrenit;

Nxënësit, përzgjedhin një moderator/e i/e cila do ta udhëheqë debatin. Nxënësit gjatë diskutimeve, mund të nxjerrin edhe përfundime.

### Vlerësimi:

Nxënësit vlerësohen për aktivizimin e tyre në debat;

Nxënësit vlerësohen për respektin ndaj të tjerëve;

Nxënësit vlerësohen për bashkëveprimin me të tjerët.

**45. ARSIMIDHE KULTURA SHOPISTARE NË GJYSMËN E DYTË TË SHEK. XIX**

|  |                          |   |                    |
|--|--------------------------|---|--------------------|
| Fusha kurrikulare:<br><b>Shqëria dhe Mjedisi</b> | Lënda:<br><b>Histori</b> | Shkalla e kurrikulës:<br><b>Shkalla 4</b> | Klasa:<br><b>8</b> |
|--|--------------------------|---|--------------------|

|   |   |
|---|---|
| <p><b>RNF:</b>1.1. Analizon çështjet shoqërore, ekonomike, kulturore e arsimore që ndikojnë në individë dhe bashkësi, si dhe argumenton ndikimin e veprimeve të njeriut në mëjdis.</p> <p>2.1. Krahason ngjarjet shoqërore, historike, politike, ekonomike e kulturore, si dhe dukuritë (fenomenet) natyrore e mëjdisore, shpjegon shkaqet dhe pasojat e tyre, si dhe ndikimin që kanë ato në jetën e njerëzve.</p> | <p><b>RNSH:</b> Kompetenca I – 5. II – 1. III - 6</p> |
|---|---|

#### **Rezultatet e të nxënësit të lëndës:**

**Nxënësi/ja:** analizon rolin e personaliteteve të rëndësishme shqiptare të periudhës moderne dhe vlerëson rolin dhe kontributin e tyre.

Identifikon personalitetet kryesore shqiptare të shek. XVI-XIX (veçanërisht ata të Rilindjes Kombëtare Shqiptare).

Përshkruan fillet e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare dhe identifikon personalitetet më të shquara shqiptare të Rilindjes dhe rolin e tyre.

**Kriteri i suksesit:** kriteri i suksesit duhet të caktohen në bashkëpunim me nxënësit në klasse.

**Fjalë kyçë:** kultura, intelektualët, arsimi, botimet, librat, revistat, shkolla, Pandeli Sotiri, Sevasti Qiriazi, Gjerasim Qiriazi.

**Burimet:** libri, fotografitë, interneti;

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo cështjet ndërkurrikulare: letërsi.

## METODOLOGIJA DHE VEPRIMTARITË

## Pjesa hyrëse:

Në këtë fazë të orës mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit që ta krahasojnë kontributin e mërgimtarëve në zhvillimin e arsimit dhe të kulturës shqiptare në gjysmën e dytë të shekullit XIX dhe kontributin e mërgimtarëve në ditët e sotme. Nxënësit bëjnë krahasime, duke i krahasuar veprimitaritë e mërgimtarëve në atë kohë dhe sot. Nxënësit i japin idetë e tyre, pa iu kufizuar dhe mohuar mendimi.

## Pjesa kryesore:

*Ruaje fjalën e fundit për mua* - Përmes kësaj teknike, nxënësit udhëzohen që ta lexojnë komplet njësinë mësimore, më pastaj të përcaktohen për pjesën që kanë përzgjedhur, që për ta është më interesante. Pjesët e zgjedhura dhe numri i faqes ku është marrë pjesa shkruhen në një fletëz, ndërsa në anën tjetër të fletës shkruhet një koment për citatin, pse e ka zgjedhur atë pjesë; cili

është mesazhi dhe rëndësia e kësaj pjesë të përzgjedhur etj. Njëri nga nxënësit e tregon faqen ku e ka zgjedhur pjesën, e lexon atë, ndërsa të tjerët e përcjellin në libër. Pas leximit të tjerët diskutojnë rrëth citatit. Në fund të diskutimit, nxënësi i cili është përcaktuar për pjesën, e lexon komentin e tij për atë citat. Pas leximit të këtij komenti, nxënësit e tjerë nuk kanë të drejtë të japid komente shtesë. E njëjtë ecuri e leximit të citatit dhe komentimit praktikohet edhe te nxënësit e tjerë.

### Përfundimi:

*Diagrami i Venit.* Në këtë fazë të mësimit, mësimdhënësi/ja vizaton në dërrasë të zezë dy rrathë të mëdhenj të ngjitur në mes vete. Të njëjtën gjë e vizatojnë edhe nxënësit në fletoret e tyre. Nxënësit udhëzohen që në rrëthin e majtë të shkruajnë: kontributi i mërgimtarëve për çështjen kombëtare në gjysmën e dytë të shek.XIX. Ndërsa në rrëthin e djathtë të shkruajnë: kontributi i mërgimtarive në ditët e sotme. Në lidhjen në mes të dy rrathëve shkruhen të përbashkëtat e dy temave. Preferohet që së pari të shkruhet për ato çka i dallojnë këto dy tema e më pas plotësohet pjesa ku specifikohen tiparet e përbashkëta. Puna bëhet individuale, pastaj në çifte dhe më pas i gjithë grupi formon një diagram të përbashkët. Prezantimi mund të bëhet nga udhëheqësit e grupeve apo mësuesi/ja. Mësimdhënësi/ja vizaton një diagram në dërrasë të zezë, duke i shkruar idetë nga diagramet që i kanë formuar grupet e nxënësve.

Kontributi i mërg. (shek.XIX)

Përbashkët

Kontributi i mërg. sot



### Aktivitete shtesë:

Nxënësit në mënyrë individuale shkruajnë ese me temën *Hapja e shkollave të para shqipe*. Secili grup e prezanton esenë më të mirë të përzgjedhur.

### Vlerësimi:

Vlerësimi i nxënësve do të bëhet në mënyrë individuale;

Vlerësimi në bashkëpunim dhe respektim në grup;

Vlerësimi në cilësinë e punimeve.

## 46. LIDHJA SHQIPTARE E PEJËS 1899

|   |                          |   |                    |
|---|--------------------------|---|--------------------|
| Fusha kurrikulare:<br><b>Shqëria dhe Mjedis</b> | Lënda:<br><b>Histori</b> | Shkalla e kurrikulës:<br><b>Shkalla 4</b> | Klasa:<br><b>8</b> |
|---|--------------------------|---|--------------------|

**RNF:** 2.1. Krahason ngjarjet shoqërore, historike, politike, ekonomike e kulturore, si dhe dukuritë (fenomenet) natyrore e mjedisore, shpjegon shkaqet dhe pasojat e tyre, po ashtu ndikimin që kanë ato në jetën e njerëzve.

**RNSH:** Kompetenca I – 2, 5. II – 3, 8.

### Rezultatet e të nxënësit të lëndës:

**Nxënësi/ja:** përshkruan pozitën e popujve të Ballkanit në kuadër të Perandorisë Osmane dhe Austro-Hungareze dhe analizon marrëdhëniet e tyre me pushtetin qendror.

**Kriteri i suksesit:** kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë;

**Fjalë kyçe:** rreziku, copëtimi, autonomia, shtetet ballkanike, vilajetet, Lidhja e Pejës, Haxhi Zeka, vrasja, Çerçiz Topulli;

**Burimet:** libri, fotografi, harta gjeografike, harta historike;

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:** gjeografi.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

### Pjesa hyrëse:

Mësimdhënësi/ja ua parashtron nxënësve pyetjet: në cilën pjesë të Kosovës shtrihet Peja? Me çfarë karakterizohet Peja? A njihni ndonjë personalitet të shquar të çështjes kombëtare të Pejës dhe cili është kontributi i tyre? Përgjigjet e tyre shënohen në dërrasë të zezë. Kjo mënyrë i bën kureshtarë nxënësit, për të ditur se çfarë do të mësojnë në vazhdim të orës mësimore.

### Pjesa kryesore:

Në këtë fazë, në fillim mësimdhënësi/ja i informon nxënësit për atë që do të lexojnë dhe gjatë leximit do të marrin shënimë. Më pas udhëzohen që fleta të ndahet në mes me një vijë vertikale. Ku më pas gjatë leximit, në të majtë të faqes shkruajnë një citat nga teksti (pjesa që u bën përshtypje), ndërsa në anën e djathtë duhet të shkruhen komentet: pse jeni përcaktuar për atë citat? Çfarë ju bëri të mendoni? Çfarë pyetjesh keni? (Komentet se përse u bëri përshtypje).

Pasi të lexojnë disa nxënës, të njëjtin lexim e bën edhe mësimdhënësi/ja. Në fund të leximit kërkohen vullnetarë (2-3 veta) që t'i japin komentet e tyre. Pas leximit të pjesës që u ka lënë përshtypje, vullnetarëve u parashtrohen pyetjet: pse u tërhoqi vëmendjen kjo pjesë? Çfarë u bëri të mendoni? Po ashtu, u parashtrohen pyetje edhe të tjerëve për përzgjedhjen që kanë bërë. Në fund mësimdhënësi/ja mund të parashtrojë këto pyetje: çfarë keni mbajtur në mend nga ky material? Cili është mesazhi më i rëndësishëm në këtë njësi?

### **Pjesa përfundimtare:**

Në këtë fazë të orës mësimore, mësimdhënësi/ja shkruan në dërrasë të zezë një pyetje me mundësi të përgjigjes me *po* dhe *jo*. Të njëjtën gjë e bëjnë nxënësit në fletore. P.sh.: sikur mos të mbahej Lidhja e Pejës, Besa-Besë, a do të merrnin vendim fuqitë e mëdha për çështjen maqedonase? Në anën e majtë shënojnë *po*, ndërsa në anën e djathë të fletës shënojnë *jo*. Pastaj duhet të argumentojnë: pse *po* dhe pse *jo*. Puna bëhet në çifte. Pastaj, çiftet bashkëpunojnë me njëritjetrin, diskutojnë, krahasojnë dhe shtojnë arsyë të tjera në listë. Pastaj, të gjithë nxënësit lëvizin nëpër grupe, duke i formuar tri grupe: grupin që është për *po*, grupin që është për *jo* dhe grupin që është i pavendosur. Pastaj, grupet që janë për *po* dhe grupet që janë për *jo*, diskutojnë për t'i përgatitur argumentet e tyre për ta forcuar pozicionin që e mbajnë. Hapet diskutimi midis anëtarëve të grupit, bëhet një debat, dhe nxënësit që i ndërrojnë bindjet e tyre mund të kalojnë nga një grup në një grup tjetër.

### **Aktivitete shtesë:**

Nxënësit në klasë e lexojnë dhe e diskutojnë librin “Shqipëria çka qenë, ç’është dhe ç’do të bëhet”.

### **Vlerësimi:**

Nxënësit vlerësohen për angazhim individual;  
Nxënësit vlerësohen për angazhim në grup;  
Nxënësit vlerësohen për interesimin e tyre për lexim.

## XV. SHQIPTARËT NË FILLIM TË SHEK. XX 47. LËVIZJA KOMBËTARE NË VITET 1908-1909

|   |                          |   |                    |
|---|--------------------------|---|--------------------|
| Fusha kurrikulare:<br><b>Shoqëria dhe Mjedisë</b> | Lënda:<br><b>Histori</b> | Shkalla e kurrikulës:<br><b>Shkalla 4</b> | Klasa:<br><b>8</b> |
|---|--------------------------|---|--------------------|

**RNF:** 2.1. Krahason ngjarjet shoqërore, historike, politike, ekonomike e kulturore, si dhe dukuritë (fenomenet) natyrore e mjedisore, shpjegon shkaqet dhe pasojat e tyre, si dhe ndikimin që kanë ato në jetën e njerëzve.

3.2. Analizon sfidat e shoqërisë (në aspektin edukativ-arsimor, kulturor, ekonomik dhe mjedisor) në kohë dhe hapësirë, duke përdorur fakte, si dhe vlerëson ndikimin e grupeve të interesit në jetën e njerëzve të zakonshëm.

**RNSH:** Kompetenca I – 5, 6. II - 8

### Rezultatet e të nxënësit të lëndës:

**Nxënësi/ja:** dallon rrymat kryesore në rrafshin kulturor dhe arsimor në periudhën moderne. Pëershruan karakteristikat kryesore të shoqërisë shqiptare gjatë kësaj periudhe dhe vlerëson zhvillimet kryesore, kulturore e arsimore.

Identifikon dhe analizon deklaratat e të drejtave të njeriut (Bill of Rights, Deklaratën e të drejtave të njeriut dhe qytetarit, Revolucionin borgjez francez).

**Kriteri i suksesit:** kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë;

**Fjalë kyçe:** lëvizja, arsimi, kongresi, alfabeti, Manastiri, Elbasani, Shkolla Normale, Gjergj Fishta, Mithat Frashëri;

**Burimet:** libri, fotografi, interneti;

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:** gjuhë, letërsi, pedagogji.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

### Pjesa hyrëse:

Mësimdhënësi/ja e fillon bashkëbisedimin me nxënës në formë të pyetjeve dhe përgjigjeve me nxënës. Nxënësit udhëzohen të shkrujnë në mënyrë individuale, përfundimisht në shquara që kanë marrë pjesë në Kongresin e Manastirit që dinë ata, pavarësisht etnisë dhe profesionit të tyre. Nxënësve nuk i kufizohet mendimi, shkrujnë lirshëm, dhe pastaj bashkëbisedojnë në çifte, grupë më vonë prezantojnë para klasës.

### Pjesa kryesore:

Përmes teknikës *Mendo, puno në çifte, thuaja grupit*, mësimdhënësi/ja i udhëzon nxënësit të lexojnë në mënyrë individuale. Më pastaj, kanë përfundimisht përzgjedhin një pjesë të njësisë

mësimore, të marrin shënime, të formulojnë pyetje për shokun, të komentojnë në dyshe e më pastaj në grup. Pasi të përfundojnë, mund të ketë edhe diskutime.

### **Pjesa përfundimtare:**

Pasi të kenë përfunduar, mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit që ta paraqesin përmes vizatimit përbajtjen e njësisë mësimore. Pasi të kenë vizatuar, fletët e tyre mund të bëhen në formë të posterit dhe të vihen në mure të klasës.

### **Aktivitete shtesë:**

Nxënësit në mënyrë individuale udhëzohen që të përzgjedhin ndonjë personalitet të shquar kombëtar, që ka marrë pjesë në Kongresin e Manastirit për të hulumtuar rrëth veprimtarisë së tij. Preferohet që të integrohet teknologjia informative e komunikimit. Pasi ta kenë përgatitur, ata/ato i prezantojnë hulumtimet e tyre përmes projektorit apo TV smart.

### **Vlerësimi:**

Nxënësit vlerësohen për punën individuale;  
Nxënësit vlerësohen për angazhimin e tyre në art;  
Nxënësit vlerësohen për shkathtësitë në përdorimin e TIK-ut;  
Nxënësit vlerësohen në përformancën e tyre gjatë prezantimeve.

## 49. LUFTËRAT BALLKANIKE

|   |                          |   |                    |
|---|--------------------------|---|--------------------|
| Fusha kurrikulare:<br><b>Shqëria dhe Mjedis</b> | Lënda:<br><b>Histori</b> | Shkalla e kurrikulës:<br><b>Shkalla 4</b> | Klasa:<br><b>8</b> |
|---|--------------------------|---|--------------------|

**RNF:**2.1. Krahason ngjarjet shoqërore, historike, politike, ekonomike e kulturore, si dhe dukuritë (fenomenet) natyrore e mjedisore, shpjegon shkaqet dhe pasojat e tyre, po ashtu ndikimin që kanë ato në jetën e njerëzve.

**RNSH:** Kompetenca I – 2, 6. II – 1, 5.

### Rezultatet e të nxënësit të lëndës:

**Nxënësi/ja:**debaton për rrethanat e krijimit të shteteve kombëtare në Ballkan.

Dallon arsyet e fillimit dhe zhvillimet kryesore të luftërave ballkanike, si dhe rrjedhojat e tyre për rajonin.

**Kriteri i suksesit:** kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë;

**Fjalët kyçë:** aleanca, Bullgaria, Serbia, Greqia, Mali i Zi, Lufta e Parë Ballkanike, trupat serbe, pushtimi, Vilajeti i Kosovës;

**Burimet:** libri, fotografi, harta gjeografike, harta historike;

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare.**  
gjeografi.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

### Pjesa hyrëse:

Mësimdhënësi/ja fillimisht e ndan klasën në dy grupe. Pastaj në dërrasë të zezë vizaton dy kolona. Në njërën kolonë, shënon fjalët kyçë: aleanca, Bullgaria, Serbia, Greqia, Lufta e Parë Ballkanike, ndërsa në kolonën e dytë, shënon këto fjalë kyçë: Lufta e Parë Ballkanike, trupat serbe, pushtimi, Vilajeti i Kosovës. Nxënësit kanë kohë 5-10 minuta për të thurur një rrëfim me këto fjalë. Pastaj, nxënësit/et lexojnë sipas dëshirës, apo sipas përzgjedhjes së mësuesit/es.

### Pjesa kryesore:

Gjatë kësaj fazë të orës nxënësit udhëzohen të lexojnë në mënyrë individuale. Më pastaj, kanë për detyrë të përzgjedhin një pjesë të njësisë mësimore, të marrin shënimë, të formulojnë pyetje për shokun, të komentojnë në dyshe e më pastaj në grup. Pasi të përfundojnë, mund të ketë edhe diskutime.

### Pjesa përfundimtare:

Pasi të kenë përfunduar, mësimdhënësi/ja kërkon nga nxënësit që të reflektojnë për njësinë e mësuar me nga një koment, ose ide. Pasi të kenë përfunduar secili grup, bën një përbledhje të

ideve apo të komenteve të tyre në një fletë të madhe formatit A0, dhe më pas këto fleta të vihen në mure të klasës. Nxënësit e grupeve të tjera i lexojnë dhe kanë të drejtë të shtojnë ide, apo të paraqesin komente rreth reflektimit. Secili grup në fund merr punimin e vet, e analizon, i shikon sugjerimet që i kanë dhënë grupet e tjera dhe i diskutojnë së bashku me të gjithë nxënësit e klasës.

#### **Aktivitete shtesë:**

Secili grup ka për detyrë të përgatitë një hulumtim, duke shfletuar literaturë edhe nga interneti, mirëpo gjithnjë duke i cituar referencat se nga i kanë marrë burimet. Grupi i parë përgatit temën: *Krijimi i Aleancës Ballkanike*; grupi i dytë: *Lufta e Parë Ballkanike*; grupi i tretë: *Lufta e Dytë Ballkanike*.

#### **Vlerësimi:**

Nxënësit vlerësohen për angazhim individual;  
Nxënësit vlerësohen për angazhim në grup;  
Nxënësit vlerësohen për përdorimin e TIK-ut për nevoja mësimore;  
Nxënësit vlerësohen në përfomancën gjatë prezantimeve.

## 50. SHPALLJA E PAVARËSISË SË SHQIPËRISË

|   |                          |   |                    |
|---|--------------------------|---|--------------------|
| Fusha kurrikulare:<br><b>Shqeria dhe Mjedis</b> | Lënda:<br><b>Histori</b> | Shkalla e kurrikulës:<br><b>Shkalla 4</b> | Klasa:<br><b>8</b> |
|---|--------------------------|---|--------------------|

**RNF:** 2.1. Krahason ngjarjet shoqërore, historike, politike, ekonomike e kulturore, si dhe dukuritë (fenomenet) natyrore e mjedisore, shpjegon shkaqet dhe pasojat e tyre, po ashtu ndikimin që kanë ato në jetën e njerëzve.

**RNSH:** Kompetenca I – 2, 5. II – 1, 5.

### Rezultatet e të nxënët të lëndës:

**Nxënësi/ja:** identifikon dhe shqyrton organizimet dhe veprimet politike e ushtarake që pasuan Lidhjen Shqiptare të Prizrenit deri në shpalljen e pavarësisë.

Analizon kontekstin historik të organizimit të Kuvendit të Vlorës dhe aktin e Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë.

**Kriteri i suksesit:** kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë;

**Fjalët kyçë:** rreziku i copëtimit, Aleanca Ballkanike, Kuvendi i Vlorës, pavarësia, Ismail Qemali, Luigj Gurakuqi, Bedri Pejani;

**Burimet:** libri, fotografitë, harta gjeografike, harta historike;

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:** ed. qytetare, sociologji, gjeografi;

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

### Pjesa hyrëse:

Mësimdhënësi/ja i ndan nxënësit në grupe. Pastaj në tabelë apo në një fletë transparente-grafofolie e shkruan: *Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë*. Nxënësit në mënyrë individuale e më pastaj në grup hartojnë një kllaster. Më pastaj, kllasterët varen në mur dhe komentohen nga udhëheqësi/ja i/e grupit.

### Pjesa kryesore:

Në vazhdim mësimdhënësi/ja nxënësve ua shpjegon detyrën si më poshtë:

Nxënësit në mënyrë individuale ta lexojnë njësinë mësimore “*Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë*”.

Gjatë leximit të paragrafëve: *Rreziku i copëtimit të tokave shqiptare; Kuvendi i Vlorës shpall Shqipërinë e Pavarur; Rëndësia historike e Shpalljes së Pavarësisë*, nxënësit vendosin nga një shenjë si më poshtë:

shenja √ (tik), informacion i cili njihet nga nxënësit;

shenja – (minus), informacion i cili është i ndryshëm nga informacioni që ka pasur më parë;

shenja + (plus), informacion i ri;

shenja ? (pikëpyetje), informacion i paqartë për nxënësin.

Gjatë kohës që e lexojnë materialin, nxënësit vendosin shenja, më pas e plotësojnë tabelën sipas udhëzimeve.

| ✓ | - | + | ? |
|---|---|---|---|
|   |   |   |   |

Në vazhdim nxënësit i lexojnë disa prej punimeve të tyre. Në këtë pjesë mësimdhënësi/ja së bashku me nxënësit komentojnë, sqarojnë dhe jepin informacione të reja, po ashtu mund të plotësojnë duke prezantuar edhe fotografi të ndryshme të personaliteteve kombëtare.

#### Pjesa përfundimtare:

Në këtë fazë mësimdhënësi/ja i udhëzon nxënësit që të reflektojnë përmes teknikës *Diagrami i Venit*. Nxënësit në mënyrë individuale do të reflektojnë për të veçantat dhe të përbashkëtat e Pavarësisë së Kosovës dhe Pavarësisë së Shqipërisë. Më pas, do t'i bashkërendojnë idetë e tyre në grup dhe në fund do të reflektojnë për tërë klasën. Mësimdhënësi/ja idetë e grupeve të ndryshme i paraqet në tabelë.

| Pavarësia e Shqipërisë | Të përbashkëtat | Pavarësia e Kosovës |
|------------------------|-----------------|---------------------|
|                        |                 |                     |

#### Aktivitete shtesë:

Mësimdhënësi/ja së bashku me nxënësit e shikojnë filmin “Nëntori i dytë”. Po ashtu disa nxënës në mënyrë vullnetare e përgatitin përbajtjen e njësisë me PowerPoint, për ta prezantuar para nxënësve të tjera në klasë. Më pastaj, vazhdojnë me komente.

## 51. QEVERIA KOMBËTARE E ISMAIL QEMALIT

|  |                          |   |                    |
|--|--------------------------|---|--------------------|
| Fusha kurrikulare:<br><b>Shoqëria dhe Mjedis</b> | Lënda:<br><b>Histori</b> | Shkalla e kurrikulës:<br><b>Shkalla 4</b> | Klasa:<br><b>8</b> |
|--|--------------------------|---|--------------------|

**RNF:** 4.1. Arsyeton llojet e vendimmarjes në jetën e përditshme shoqërore, ku ton nevojën dhe rëndësinë e zbatimit të procedurave demokratike përgjatë proceseve.

**RNSH:** Kompetenca  
**I – 2, 6. II – 5. IV – 1.**

### Rezultatet e të nxënëtit të lëndës:

**Nxënësi/ja:** dallon sistemet e ndryshme shtetërore e qeverisës të periudhës moderne dhe krahason mënyrat e vendimmarjes institucionale (absolutizmi dhe parlamentarizmi).

**Kriteri i suksesit:** kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë;

**Fjalë kyçë:** qeveria, Ismail Qemali, ministrat, Fuqitë e Mëdha, Qeveria e Durrësit, Esat Toptani;

**Burimet:** libri, fotografi, harta gjeografike, harta historike;

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:** ed. qytetare.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

### Pjesa hyrëse:

Pasi nxënësit të jenë ndarë në katër grupe (4-6 nxënës), mësimdhënësi/ja i shkruan në tabelë këto fjalë: Ismail Qemali, ministrat, fuqitë e mëdha, Qeveria e Durrësit, Esat Toptani. Mandjej, i fton nxënësit të mendojnë e të diskutojnë në çifte dhe në grupe për fjalët e shënuara. Pasi diskutojnë dhe i japin mendimet e tyre, nxënësit të shkruajnë për 5 minuta një shkrim të lirë ose të ndërtojnë një rrëfim personal që gjithnjë do të ketë për bazë këto fjalë kyçë. Në fund të kësaj faze, mësimdhënësi/ja fton disa prej nxënësve që t'i lexojnë shkrimet.

### Pjesa kryesore:

Nxënësit e ndarë në grupe nga 4-6 anëtarë, udhëzohen ta lexojnë tërë njësinë mësimore. Pas 10 minutash lexim, mësimdhënësi/ja me short ua cakton grupeve nga një pjesë të njësisë mësimore (nëntitull, të cilët kanë për detyrë të hartojnë nga 3 deri në 5 pyetje për grupet e tjera. Çdo grup do ta zgjedhë përfaqësuesin e vet për t'iu përgjigjur pyetjeve që vijnë nga grupet e tjera.

### Pjesa përfundimtare:

Në këtë fazë mësimdhënësi/ja të gjitha grupet i pajis me nga një fletë të bardhë të formatit A0, ku nxënësit duhet të formojnë një poster me reflektim nga njësia mësimore. Pastaj, përfaqësuesi i

grupit del dhe e prezenton para klasës. Nxënësit e tjerë kanë të drejtë të bëjnë pyetje, për të marrë informacion sa më të saktë.

### **Aktivitete shtesë:**

Nxënësit e ndarë në grupe, sipas shkathësive të tyre e përzgjedhin teknikën se si të reflektojnë sa më mirë për Ismail Qemailin. Ndonjë nxënës, që ka talent përvizatim, e bën portretin e tij, nxënësi tjetër, që ka talent në letërsi, shkruan ndonjë poezi për të, tjetri përgatit një film të shkurtër dokumentar e kështu me radhë, duke u bërë gjithëpërfshirja e nxënësve. Pas kësaj, nxënësit e prezentojnë punën e tyre para klasës, ndonjëherë edhe para prindërve dhe aktorëve të tjerë të shkollës.

### **Vlerësimi:**

Nxënësit/et vlerësohen për angazhim në grup;

Nxënësit/et vlerësohen në shkathësi për integrimin e lëndëve;

Nxënësit/et vlerësohen në angazhim individual.

## 52. KONFERENCA E AMBASADORËVE NË LONDËR DHE NJOHJA E PAVARËSISË SË SHQIPËRISË

|   |                          |   |                    |
|---|--------------------------|---|--------------------|
| Fusha kurrikulare:<br><b>Shqipëria dhe Mjedis</b> | Lënda:<br><b>Histori</b> | Shkalla e kurrikulës:<br><b>Shkalla 4</b> | Klasa:<br><b>8</b> |
|---|--------------------------|---|--------------------|

**RNF:** 2.2. Shpjegon përbërjen e gjeosferës, si dhe analizon rolin e resurseve natyrore në mjedisin dhe në zhvillimin ekonomik të një vendi, rajoni, shteti apo kontinenti.

**RNSH:** Kompetenca

### Rezultatet e të nxënët të lëndës:

**Nxënësi/ja:** evidenton kontradiktat midis fuqive evropiane për sferat e interesit në botë dhe përkufizion ekspansionin kolonialist të tyre.

**Kriteri i suksesit:** kriteri i suksesit duhet të caktohet në bashkëpunim me nxënësit në klasë;

**Fjalë kyçë:** Konferenca e Ambasadorëve, Eduard Grey, kufijtë, projekt austro-hungarez, njohja ndërkombëtare;


**Burimet:** libri, fotografi, harta gjeografike, harta historike, interneti;

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:** gjeografi, ed. qytetare.

## METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË

### Pjesa hyrëse:

Mësimdhënësi/ja e ndan klasën në grupe prej 6 nxënësish dhe u kërkon atyre të plotësojnë një kllaster me fjalët *Njohja e Pavarësisë së Shqipërisë*. Pas pesë minutash, një nxënës e lexon punën e grupit. Mendimet e nxënësve mund të shkruhen në tabelë, duke bërë një kllastër i cili mund të plotësohet me ide të reja nga grupei vijues. Nga nxënësit kërcohët që fjalët apo fjalitë e treguara nga grupei paraprak të mos përsëriten për shkak të kohës së kufizuar.



### Pjesa kryesore:

Mësimi lexohet në mënyrë individuale. Gjatë leximit nxënësit mbajnë shënimë për pyetjet e të reja që u lindin apo për gjërat që nuk i kanë të qarta. Zhvillohet një diskutim rreth tyre dhe u jepen

shpjegim koncepteve kryesore të mësimit, siç janë: Konferenca e Ambasadorëve, Eduard Grey, kufijtë, projekt Austro-hungarez, njohja ndërkombëtare.

#### **Pjesa përfundimtare:**

Këtë fazë të orës mësimore mësimdhënësi/ja mund ta realizojë përmes teknikës *Pyetje binare apo pyetje dyfishe*. Pasi nxënësit ta kenë lexuar mirë njësinë mësimore dhe kanë hasur apo kanë shqyrtuar një temë që në vetvete përmban edhe kontradikta, mësimdhënësi/ja shtron një pyetje, e cila i nxit nxënësit për debat dhe ofrim të argumenteve *për* dhe *kundër*.

#### **Aktivitete shtesë:**

Nxënësit e ndarë në tri grupe mund të diskutojnë për këto tri çështje: a) t'i identifikojnë çështjet kryesore që i shqyrtoi konferenca; b) ta analizojnë vendimin: “Shqipëria bëhet principatë sovrane dhe e trashëgueshme”; c) t'i krahasonjnë territoret që mbetën në shtetin e pavarur shqiptar dhe të tjerat që mbetën jashtë trungut kombëtar.

#### **Vlerësimi:**

Nxënësit vlerësohen për angazhim individual;

Nxënësit vlerësohen për bashkëpunim në grup;

Vlerësohen për pjesëmarrje në diskutim;

Vlerësohen për kulturë komunikuese.



